

# **GJYKATA SUPREME**

**Prishtinë**

**Numri i rastit:** PA II 11/2016  
**(P Nr. 938/13 Gjykata Themelore e Mitrovicës)**  
**(PAKR Nr. 445/15 Gjykata e Apelit)**

**Data:** 3 korrik 2017

## **NË EMËR TË POPULLIT**

**Gjykata Supreme e Kosovës**, në një kolegji të përbërë nga Gjyqtari i EULEX-it Krassimir Mazgalov (Kryesues dhe Raportues), Gjyqtari i EULEX-it Arnout Louter dhe Gjyqtari i Gjykatës Supreme Emine Mustafa si anëtarë të Panelit dhe Zyrtari Ligjor i EULEX-it Sandra Gudaityte si procesmbajtëse, në rastin penal kundër, ndër të tjera, të pandehurve:

**JD;**

**SL;**

**SS;**

*të akuzuar sipas Aktakuzës PPS 88/11 të datës 8 nëntor 2013 (në tekstin e mëtejme "Aktakuza") me një numër akuzash për Krime Lufte kundër Popullsisë Civile, në kundërshtim me nenin 22 dhe 142 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (Gazeta Zyrtare RSFRJ nr. 44, datë 8 tetor 1976) (në tekstin e mëtejme KPRSFJ) (aktualisht i kriminalizuar sipas neneve 31 dhe 152 të Kodit Penal të Kosovës (në tekstin e mëtejme: KPK) dhe në shkelje me nenet e përbashkëta 3 dhe 4 të Protokollit Shtesë II, të gjitha rregullat e ligjit ndërkombëtar që*

ishin në fuqi në kohën e konfliktit të brendshëm në Kosovë dhe në çdo kohë relevante me Aktakuzën;

*Duke vepruar sipas ankesave të parashtruara nga avokati mbrojtës në emër të MS të pandehurit JD më 29 nëntor 2016, mbrojtësi në emër të GS të pandehurit SS më 30 nëntor 2016 dhe avokati mbrojtës AK në emër të pandehurit SL më 29 nëntor 2016;*

*Pas shqyrtimit të përgjigjeve ndaj ankesave të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit (në tekstin e mëtejshëm "Prokuroria") të parashtruara më 20, 21 dhe 22 dhjetor 2016;*

*Pas mbajtjes së seancës publike më 20 qershor 2017*

*Pas shqyrtimit dhe votimit më 3 korrik 2017;*

*Në bazë të neneve 398, 403 dhe 407 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: 'KPP')*

*Nxjerrë këtë:*

## **AKTGJYKIM**

---

- I. Ankesa e parashtruar nga avokati mbrojtës në emër të pandehurit JD më 29 nëntor 2016 refuzohet si e pabazuar.**
- II. Ankesa e parashtruar nga avokati mbrojtës në emër të pandehurit SS më 30 nëntor 2016 aprovohet pjesërisht.**
- III. Aprovohet ankesa e parashtruar nga avokati mbrojtës në emër të pandehurit SL më 29 nëntor 2016.**

**IV. Aktgjykimi PAKR Nr. 445/15 i Gjykatës së Apelit i lëshuar më 15 shtator 2016  
modifikohet vetëm lidhur me Akuzën IX si në vijim:**

Në bazë të nenit 364 (1) (1.3) të KPP, të pandehurit SL dhe SS lirohen nga akuza në vijim sepse nuk është vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm se të pandehurit SS dhe SL kanë kryer veprën penale si në vijim: se në kapacitetin e tyre si anëtarë të UÇK-së dhe personave që ushtrojnë kontroll efektiv mbi qendrën e paraburgimit në Likoc (kushtet, rregulloret dhe personat që duhet të mbahen dhe / ose lirohen), në bashkëkryerje me njëritjetrin, kanë shkelur integritetin trupor dhe shëndetin (p.sh. të burgosurit e lidhur me zinxhirë, mjediset e papërshtatshme, nxehtësia e tepruar, mungesa sanitare, ushqimi joadekuat, rrahjet e shpeshta) të një numri të pidentifikuar të civilëve shqiptarë të ndaluar në qendrën e paraburgimit në Likoc (komuna e Skenderajt) nga viti 1998 deri në muajt e parë të vitit 1999 që u cilësua si Krime të Luftës kundër Popullatës Civile në shkelje të nenit 142 të KPRSFJ (aktualisht i kriminalizuar nën nenin 31 dhe 152 të KPRK-së) dhe në kundërshtim me nenet e përbashkëta 3 dhe 4 të Protokollit Shtesë II, të gjitha rregullat e së drejtës ndërkombëtare që ishin në fuqi në kohën e konfliktit të brendshëm në Kosovë dhe gjithnjë në lidhje me Aktakuzën.

**Dënimi është modifikuar si në vijim:**

Në lidhje me të pandehurin SS: Në bazë të neneve 80 (1), (2) (2.2) dhe 82 (1) të KPK-së, duke marrë parasysh se i pandehuri është dënuar me 5 (pesë) vite dhe 3 (tre) muaj burgim për veprën penale siç përshkruhet në Akuzën IV dhe më parë është dënuar me 7 (shtatë) vjet burgim me Aktgjykimin PAKR Nr. 456/15 të Gjykatës së Apelit të datës 14 shtator 2016, të pandehurit i shqiptohet dënimi i përgjithshëm me 8 (tetë) vjet burgim.

Në lidhje me të pandehurin SL: Në pajtim me nenin 364 (1) (1.3) të KPP-së, i pandehuri lirohet nga vepra penale siç është detajuar në Akuzën IX; prandaj, në pajtim me nenin 403 (4) të KPP-së, paraburgimi kundër SL pushon dhe i pandehuri lirohet menjëherë.

**V. Pjesët e mbetura të ankesës të parashtruar nga mbrojtësi në emër të të pandehurit  
SS më 30 nëntor 2016, refuzohen si të pabazuara.**

**ARSYETIM**

**I. Historiku procedural**

1. Më 8 nëntor 2013, Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm "PSRK") ngriti aktakuzën kundër SD, SL, SS dhe të pandehurit tjetër duke i akuzuar ata me disa akuza për Krime të Luftës kundër Popullatës Civile, në kundërshtim me nenin 22 dhe 142 të KPRSFJ-së (aktualisht kriminalizuar sipas neneve 31 dhe 152 të KPK-së) dhe në kundërshtim me nenet e përbashkëta 3 dhe 4 të Protokollit Shtesë II, të gjitha rregullat e së drejtës ndërkombëtare efektive në kohën e konfliktit të brendshëm në Kosovë dhe në çdo kohë të rëndësishme për Aktakuzën.
2. Gjykimi filloi më 22 maj 2014 dhe u mbyll më 27 maj 2015. Ai përbëhej nga 46 seanca gjyqësore. Më 27 maj 2015, Gjykata Themelore e Mitrovicës ka dhënë aktgjykimin e saj P 938/13. **JD** u lirua nga akuzat penale siç është detajuar në akuzën e vetme të trajtuar në rastin në fjalë. **SL** u shpall fajtor për veprën penale në vijim: se duke vepruar në mënyrë brutale me dashje mori jetën e një mashkulli të paidentifikuar shqiptar rreth 40 (dyzet) vjeç duke vënë një pistoletë të tipit TT në kokën e mashkullit derisa ai i kishte duart e tij të lidhura dhe ruhej nga dy ushtarë të paidentifikuar të UÇK-së, më pas e kishte qëlluar mashkullin në kokë me tri të shtëna duke shkaktuar vdekjen e tij, në një vend të papërcaktuar ndërmjet fshatrave të Galicës dhe Dubovcit, në një datë të papërcaktuar në shtator të vitit 1998 dhe ky veprim është klasifikuar si vrasje sipas nenit 30 (2) (1) të Ligjit Penal të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës të 28 qershorit 1977 (në tekstin e mëtejshëm "LPKSAK") (në tekstin e mëtejshëm do të referohemi si "Akuza I" bazuar në numrin e paragrafit të dispozitivit të aktgjyimit të Gjykatës Themelore), dhe dënohet me 12 (dymbëdhjetë) vjet burgim. **SL** u lirua nga veprat penale të detajuara në dy (2) akuzat e mbetura. **SS** u shpall fajtor për veprën penale në vijim: gjatë konfliktit të brendshëm të armatosur në Kosovë, në disa raste, në gusht dhe shtator 1998, duke vepruar si anëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm

"UÇK"), e shkeli rëndë nenin 3 i përbashkët me katër Konventat e Gjenevës të 12 gushtit 1949, sepse ai qëllimisht kreu dhunë, trajtim mizor dhe torturë kundër Dëshmitarit A, një civil shqiptar i Kosovës i ndaluar në objektin e paraburgimit të UÇK-së në Likoc (komuna Skenderaj), i cili nuk mori pjesë aktive në veprime ushtarake, duke e rrahur atë me grushte dhe shuplaka brenda qelisë së ndalimit dhe ky veprim sipas nenit 33 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës është klasifikuar si një krim lufte në vazhdimësi sipas neneve 152 (1) dhe 2 ) (2.1) dhe 81 (1) të KPK-së, në kundërshtim me nenin 4 (2) (a) të Protokollit Shtesë II të Konventave të Gjenevës (në tekstin e mëtejme do të quhet "Akuza II" në bazë të numrit të paragrafit të dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës Themelore), dhe dënohet me 6 (gjashtë) vjet burgim. I pandehuri u lirua nga veprat penale të detajuara në 4 (katër) akuzat e mbetura.

3. Më 6, 7 dhe 10 gusht 2015, PSRK dhe avokati mbrojtësi në emër të SS dhe SL parashtruan ankesat e tyre kundër Aktgjykimit P 938/13 të Gjykatës Themelore të Mitrovicës.
4. Më 15 shtator 2016, Gjykata e Apelit mori aktgjykimin PAKR 455 / 15. Gjykata e Apelit e aprovoi ankesën e parashtruar nga avokati mbrojtës në emër të pandehurit SL dhe e liroi të pandehurin për veprën penale siç përshkruhet në Akuzën I, pasi nuk është vërtetuar se i akuzuari ka kryer veprën me të cilën është akuzuar. Gjykata e Apelit më tej i aprovoi ankesat e avokatit mbrojtës të SS dhe e refuzoi akuzën kundër të pandehurit ashtu siç është përshkruar në Akuzën II sepse ishte pjesë materiale dhe faktike e një vepre penale në vazhdim për të cilën i pandehuri ishte dënuar më parë.
5. Gjykata e Apelit më tej e aprovoi pjesërisht ankesën e PSRK-së dhe ndryshoi Aktgjykimin P 938/13 të Gjykatës Themelore të Mitrovicës duke gjetur të pandehurit SS dhe JD fajtor për veprën penale në vijim: gjatë konfliktit të brendshëm armatosur në Kosovë, në një rast, ndërmjet fillimit të gushtit deri në fund të shtatorit 1998, duke vepruar si anëtarë të UÇK-së dhe në bashkëkryerje me njëri-tjetrin ashtu siç është përcaktuar në nenin 31 të KPK-së, qëllimisht kanë cenuar integritetin trupor dhe shëndetin e një personi të paidentifikuar shqiptar nga zona e Shipolit në Mitrovicë, të paraburgosur në qendrën e paraburgimit në Likoc duke e rrahur atë vazhdimisht, në këtë rast të klasifikuar si një krim lufte sipas nenit 152 (1) dhe (2) (2.1), (2.2) të KPK-së dhe në kundërshtim me nenin 4 (2) (a)

të Protokollit Shtesë II të Konventave të Gjenevës, në lidhje me nenin 33 (2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme do t'i referohemi si "Pika IV" e aktakuzës bazuar në numrin e paragrafit të dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës Themelore). Për këtë veprë penale, Gjykata e Apelit e dënoi SS me 5 (pesë) vjet dhe 3 (tre) muaj burgim dhe JD me 5 (pesë) vjet burgim.

6. Gjykata e Apelit më tej ndryshoi Aktgjykimin P 938/13 të Gjykatës Themelore të Mitrovicës duke gjetur të pandehurit SS dhe SL fajtor dhe duke e liruar të pandehurin SJ nga vepra penale në vijim: në cilësinë e tyre si anëtarë të UÇK-së dhe personave që ushtronin kontroll në qendrën e paraburgimit në Likoc, në bashkëkryerje me njëri-tjetrin ashtu siç është përcaktuar në nenin 31 të KPK-së, kanë cenuar integritetin trupor dhe shëndetin e një numri të pidentifikuar të civilëve shqiptarë të paraburgosur në qendrën e paraburgimit duke i mbajtur ata në mjedise të papërshtatshme me mungesë të kanalizimeve, ushqim të papërshtatshëm, që kanë pësuar rrahje të shpeshta, së paku gjatë muajve gusht dhe shtator të vitit 1998, në këtë rast të klasifikuar si një krim luftime sipas neneve 152 (1) dhe (2) (2.1), 2.2 të KPK-së; dhe në rastin e SL, në lidhje me nenin 161 (1) (1.1) të KPK-së, në kundërshtim me nenin 4 (2) (a) të Protokollit Shtesë II të Konventave të Gjenevës, në lidhje me nenin 33 (2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme do t'i referohemi si "Pika IX" e aktakuzës bazuar në numrin e paragrafit të dispozitivit të Aktgjykimit të Gjykatës Themelore). Për këtë veprë penale SS është dënuar me 8 (tetë) vjet burgim dhe SL me 7 (shtatë) vjet burgim. Në bazë të neneve 80 (1) dhe (2.2) dhe 82 (1) të KPK-së dhe duke marrë parasysh dënimin e shqiptuar në aktgjykimin e Gjykatës së Apelit në rastin PAKR 456/2015 të datës 14 shtator 2016, SS i është shqiptuar dënimi i përgjithshëm me 10 (dhjetë) vjet burgim.
7. Gjykata e Apelit më tej ndryshoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në lidhje me llogaritjen e kohës së kaluar në paraburgim si në vijim: në bazë të nenit 83 (1) të KPK-së, periudha e privimit nga liria e SS, JD dhe SL në arrest shtëpiak nga data 23 maj 2013 deri më 31 maj 2013, në paraburgim nga data 31 maj 2013 deri më 19 dhjetor 2014, dhe në paraburgim nga data 27 maj 2015 deri në lëshimin e Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit do të pranohet për dënimin me burgim të shqiptuar ndaj të pandehurve.

8. Më 29 nëntor 2016, avokati mbrojtës parashtrroi ankesë në emër të të pandehurit JD kundër Aktgjykimit PAKR Nr. 445/15 të Gjykatës së Apelit, që është marrë më 15 shtator 2016, duke i propozuar Gjykatës Supreme që të ndryshojë aktgjykimin e kundërshtuar dhe ta lirojë të pandehurin nga të gjitha akuzat ose të anulojë aktgjykimin e kundërshtuar dhe ta dërgojë çështjen në rigjykim dhe të ndërpresë paraburgimin.
9. Më 29 nëntor 2016, avokati mbrojtës parashtrroi ankesë në emër të të pandehurit SL kundër ankesës PAKR nr. 445/15 të Gjykatës së Apelit, më 15 shtator 2016, duke i propozuar Gjykatës Supreme të anulojë ose ndryshojë aktgjykimin e kundërshtuar dhe të lëshojë aktgjykim të lirimit, ose të anulojë aktgjykimin e kundërshtuar dhe të dërgojë çështjen në rigjykim në pajtim me nenin 398 (1) (1.3) të KPP-së.
10. Më 30 nëntor 2016, avokati mbrojtës parashtrroi ankesë në emër të të pandehurit SS kundër Aktgjykimit PAKR nr. 445/15 të Gjykatës së Apelit, që është marrë më 15 shtator 2016, duke i propozuar Gjykatës Supreme për të ndryshuar dënimet dhe për të rivendosur vendimet liruese.
11. Më 20, 21 dhe 22 dhjetor 2016, Prokuroria i paraqiti përgjigjet e saj ndaj ankesave duke i propozuar Gjykatës Supreme t'i shpallë ankesat si të vonuara ose, përndryshe, t'i refuzojë ankesat si të pabazuara.

## **II. Parashtrësat e palëve**

### Parashtrësat në emër të JD

12. Avokati mbrojtës pretendon se Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit përmban shkelje të konsiderueshme të dispozitave të procedurës penale, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkelje të ligjit penal dhe vendim të gabuar për dënimin. Prandaj, mbrojtja i propozon Gjykatës Supreme që të ndryshojë Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit PAKR

455/15 duke e liruar JD ose të anulojë Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit PAKR 455/15 dhe ta dërgojë çështjen në rigjykim dhe të ndërpresë paraburgimin kundër të akuzuarit.

13. Avokati mbrojtës pretendon se aktgjykimi i kontestuar përmban shkelje të konsiderueshme të dispozitave të procedurës penale dhe vërtetim të gabuar të fakteve dhe rrethanave. Mbrojtja pretendon se Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit përmban shkelje të ligjit sepse JD është shpallur fajtor për veprën penale të cilën ai nuk e ka kryer. Pretendimet specifike të ngritura nga avokati mbrojtës do të trajtohen në arsyetimin e këtij aktgjykimi.

Parashtrësit në emër të SL

14. Mbrojtja pretendon se Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit PAKR 455/15 i datës 15 shtator 2016 përmban shkelje esenciale të dispozitave procedurale, domethënë shkelje të parimit *in dubio pro reo* dhe vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike. Prandaj, mbrojtja i propozon Gjykatës Supreme të anulojë ose të ndryshojë aktgjykimin e kundërshtuar dhe të lëshojë aktgjykim lirues ose në pajtim me nenin 398 (1) (1.3) të KPP-së të anulojë aktgjykimin e kundërshtuar dhe të dërgojë rastin në rigjykim. Pretendimet specifike të ngritura nga avokati mbrojtës do të trajtohen në arsyetimin e këtij aktgjykimi.

Parashtrësit në emër të SS

15. Mbrojtja pretendon se Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit mbështetet në standardet ligjore të aplikuara në mënyrë të paqëndrueshme, mos marrjen parasysh të të dhënave dëshmuese në tërësi dhe keqinterpretimin e provave gjyqësore, pasqyron gabime të rëndësishme ligjore dhe faktike dhe përbën një dështim për të siguruar një mendim juridik të paarsyetuar nga një gjykatë neutrale dhe e paanshme. Prandaj, mbrojtja i propozon Gjykatës së Lartë për të ndryshuar dënimet dhe për të rivendosur vendimet liruese. Pretendimet specifike të ngritura nga avokati mbrojtës do të trajtohen në arsyetimin e këtij aktgjykimi.



Përgjigjet e Prokurorisë

16. Prokurori kërkon që Gjykata Supreme të refuzojë ankesat e avokatit mbrojtës në emër të JD, SL dhe SS si të vonuara ose, përndryshe, si të pabazuara. Prokurori pretendon se të tri ankesat duhet të shpallen të vonuara për shkak se afati 10-ditor i përcaktuar në nenin 379 të KPP-së nuk ishte përmbushur.
17. Në lidhje me përbërjen e kolegjit, Prokurori vë në dukje se mbrojtja nuk e ngriti kundërshtimin e saj lidhur me përbërjen e kolegjit në fillim të gjyqimit. Për më tepër, është praktikë e përgjithshme në Gjykatën Themelore të Mitrovicës për të siguruar që rastet që bien nën juridiksionin e kësaj gjykate do të gjykohen.
18. Sipas Prokurorit, pretendimet e mbrojtjes se procedura nuk ka përfunduar brenda një kohe të arsyeshme janë jo meritore. Aktgjykimi i Gjykatës Themelore është lëshuar brenda një viti nga momenti i fillimit të gjyqimit. Koha që ka kaluar ndërmjet parashtrimit të ankesës së PSRK-së dhe lëshimit të Aktgjyqimit të Gjykatës së Apelit nuk ndikon tek i pandehuri pasi ai nuk ka qenë në paraburgim.
19. Në lidhje me pretendimet për një dispozitiv të pakuptueshëm, Prokurori pretendon se dispozitivi i Aktgjyqimit të Gjykatës së Apelit i plotëson kërkesat e përcaktuara në nenin 370 të KPP-së. Përveç kësaj, dispozitivi duhet të lexohet së bashku me arsyetimin e aktgjyqimit.
20. Prokurori pohon se si rregull i përgjithshëm, dënimi mund të bazohet në dëshminë e një dëshmitari. Kjo është një praktikë përgjithësisht e pranuar e gjykatave ndërkombëtare dhe është e lejuar sipas nenit 262 të KPP-së. Prokurori pretendon se kërkesat e përcaktuara në nenin 262 të KPP-së janë përmbushur plotësisht.
21. Në lidhje me konceptin e dëshmitarit armiqësor, Prokurori pajtohet me avokatin mbrojtës se ky koncept nuk është parashikuar shprehimisht në KPP. Megjithatë, ky koncept rrjedh nga

detyrimi për të kryer një gjykim të drejtë. Në rast të armiqësisë së një dëshmitari, provat e marra përmes marrjes së tërthortë në pyetje dëshmitari nga ana e palës që e ka thirrur dëshmitarin bie në diskrecionin e plotë të gjykatës për të konsideruar provat si të pranueshme, relevante dhe me vlerë provuese. Prandaj, marrja e tërthortë në pyetje e prokurorisë nuk ishte në kundërshtim me nenet 333 dhe 334 të KPP-së.

22. Në lidhje me marrjen në pyetjet të dëshmitarit nga Kryetari i Trupit Gjyqësor i Gjykatës Themelore, Prokurori pretendon se kolegji në procedurë nuk është vëzhgues pasiv dhe ka të drejtë të bëjë pyetje për të përmbushur detyrat e tyre sipas nenit 7 të KPP-së.
23. Prokuroria pretendon se megjithëse Aktakuza nuk është e qartë lidhur me përgjegjësinë komanduese, mbrojtja është vënë në dijeni për të gjatë shqyrtimit kryesor. Sipas nenit 360 (2) të KPP-së, gjykata nuk do të jetë e detyruar me propozimet e prokurorit të shtetit lidhur me klasifikimin juridik të aktit. Në këtë rast duhet të plotësohen disa kërkesa - mbrojtja duhet të njoftohet dhe të ketë një mundësi për të avancuar mbrojtjen e tyre në lidhje me akuzën e riformuluar. Në rastin aktual, mbrojtja është njoftuar si dhe kishte mundësi për të avancuar mbrojtjen e tyre në lidhje me këtë mënyrë të përgjegjësisë.
24. Në lidhje me testin e kontrollit efektiv në lidhje me përgjegjësinë komanduese, Prokuroria pretendon se kjo është çështje e provave dhe duhet të merret në konsideratë në dritën e rrethanave të të gjithë rastit. Ndërsa është e vërtetë që kontrolli *de jure* nuk provon automatikisht kontrollin efektiv, Gjykata e Apelit ka vërtetuar në mënyrë efektive se ekzistonte një qendër paraburgimi që kishte një numër të paraburgosurish të cilët u ishin nënshtruar një trajtimi të egër. Gjykatat e shkallës së parë dhe të dytë kanë vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm se SL [ka pasur pozitën] dhe SS [ka pasur pozitën] dhe *de jure* ka qenë eprori i ushtarit të UÇK-së që ka drejtuar qendrën e paraburgimit. Për më tepër, gjatë procesit gjyqësor nuk ishin paraqitur prova që tregonin ndonjë çarje në strukturat komanduese. Dëshmitari BG tregoi qartë se SL dhe SS merreshin me çdo çështje lidhur me UÇK-në. Kjo dëshmi konfirmohet nga Dëshmitari D i cili deklaroi se të gjithë e dinin se kush ishte komandanti i tyre.

25. Në lidhur me elementin mendor, Prokuroria thekson se Gjykata e Apelit me të drejtë ka konstatuar se qendra e paraburgimit gjendej në Shtabin e UÇK-së të Zonës së Drenicës. SL ishte shpesh i pranishëm në shtëpinë. Ai me gjasë nuk ka mundur ta ketë humbur praninë e të paraburgosurve dhe keqtrajtimin e tyre. Andaj, Prokuroria pretendon se Gjykata e Apelit ka vërtetuar saktë se është dëshmuar përtej dyshimit të arsyeshëm se SL e ka ditur që të paraburgosurit ishin keqtrajtuar.
26. Prokuroria ka treguar se Gjykata e Apelit korrigjoi me të drejtë gabimin që e ka bërë trupi gjykues lidhur me keqtrajtimin e përgjithshëm të burgosurve. Dëshmitari A e ka përshkruar qartazi trajtimin brutal që ai e kishte pësuar dhe ka treguar se të burgosurit tjerë ishin keqtrajtuar rëndë. Deklarata e Dëshmitarit D e vërteton dëshminë e Dëshmitarit A. Madje dhe nëse Gjykata e Apelit e deklaron dëshminë e këtij dëshmitari si jo të besueshme, ajo prapë ka disa vlera provuese.
27. Prokuroria nuk pajtohet me mbrojtjen se është e nevojshme të provohen lëndimet ashtu që lëndimet trupore të konsiderohen si krim lufte. Dëshmia lidhur me rrahjen e një burri të pidentifikuar nga zona e Shipolit të Mitrovicës tregon qartazi trajtimin poshtërues.
28. Lidhur me besueshmërinë e dëshmisë së Dëshmitarit A, Prokurori pretendon se vlerësimi i Gjykatës së Apelit është ai se ka mundur të bëhet një gjykim i arsyeshme i faktit. Prokurori thekson mospërputhjet e vogla në dëshminë e dëshmitarit që mund të shpjegohen me faktin se dëshmitari ka dëshmuar 16 vjet pas ngjarjeve, ka qenë nën trysni të mbrojtjes dhe ka qenë tepër i marrë tërthoras në pyetje. Sulmi i mbrojtjes në integritetin personal është pa merita dhe këtë e ka adresuar Gjykata e Apelit. Në fund, Prokurori thekson se gjykatat duhet të japin një kufi të ndershmërisë në gjetjen e fakteve nga trupi gjykues sepse trupi gjykues është vendi më i mirë për vlerësimin e dëshmive.

### **III. Përbërja e Kolegjit**

29. Kolegji ka vërtetuar se më 27 prill 2017 (KGJK Nr. 124/2017), Këshilli Gjyqësor i Kosovës (më tej “KGJK”) ka vërtetuar se ankesat ndaj Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit për rastin në fjalë duhet të gjykohen nga një kolegji i përbërë në shumicë të Gjyqtarëve të EULEX-it dhe i kryesuar nga një gjyqtar i EULEX-it.

#### IV. Gjetjet e Trupit Gjykses

- *Ligji i procedurës penale në fuqi*

30. Lidhur me dispozitat e procedurës penale të zbatueshme në procedurën në fjalë, Kolegji vëren se sipas Nenit 540 të KPP, për çdo procedurë penale të filluar para hyrjes në fuqi të KPP (1 janar 2013), por pa ndonjë aktakuzë të ngritur, duhet të zbatohen dispozitat e KPP *mutatis mutandis*. Në rastin në fjalë, hetimet kishin filluar më 19 janar 2012. Aktakuza në rastin në fjalë ishte ngritur më 8 nëntor 2013. Prandaj, kodi i procedurës penale i zbatueshëm në këtë rast është KPP që është në fuqi nga 1 Janari 2013.

- *Pranueshmëria e ankesave*

31. Prokurori pretendon se që të tri ankesat duhet të shpallen si të vonuara sepse afati prej 10 ditësh, i paraparë në Nenin 379 të KPP nuk ishte respektuar.

32. Shumica e Kolegjit konsideron se në rastin e ankesave të shkallës së tretë, duhet të zbatohet afati për paraqitjen e ankesave i përcaktuar në nenin 380 të KPP-së. Shumica e Kolegjit është më tej i mendimit se neni 380 i KPP në mënyrë ekskluzive tregon se ankesa ndaj në aktgjykimi të nxjerrë nga Gjyqtari i Vetëm Gjykses apo nga Trupi Gjykses i Gjykatës Themelore duhet të parashtrohet brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Megjithatë, ky nen është në kapitullin e titulluar

“Ankesat kundër Aktgjykimeve” i cili gjithashtu përfshinë ankesat në shkallë të tretë. Më tej, në përputhje me Nenin 407(2) të KPP, dispozitat që e përcaktojnë procedurën e ankesave në Gjykatën e Apelit duhet të jenë *mutatis mutandis* të zbatueshme në procedurën e ankesave pranë Gjykatës Supreme. Neni 380 i KPP e rregullon qartazi aspektin procedural të procedurës së apelit dhe duhet të shtrihet në procedurën ankimore në Gjykatën Supreme. Në fund, çdo dyshim lidhur me ligjin në fuqi duhet të konsiderohet në dobi të të pandehurit.

33. Prandaj, Shumica e Kolegjit konsideron se edhe pse nuk tregohet shprehimisht, neni 380 i KPP duhet të jetë i zbatueshëm në ankesën në shkallën e tretë. Kjo është në përputhje me praktikën e përgjithshme të Gjykatës Supreme.

34. Si e tillë, Shumica e Kolegjit konsideron se ankesat e parashtruara nga avokati mbrojtës MS në emër të të pandehurit JD, më 29 nëntor 2016, avokatit mbrojtës GS në emër të të pandehurit SS më 30 nëntor 2016, dhe avokatit mbrojtës AK në emër të të pandehurit SL më 29 nëntor 2016 janë të pranueshme. Ato lejohen (Neni 407(1) i KPP) dhe janë parashtruar nga një person i autorizuar (Neni 381(1) i KPP), brenda afatit të paraparë (Neni 380(1) i KPP) dhe pranë gjykatës kompetente (Neni 374(1)(1.1) i KPP).

*- Trupi Gjykues i Gjykatës Themelore ishte i përbërë në shkelje të ligjit*

35. Mbrojtja e JD pretendon se Gjykata Themelore e ka shkelur Nenin 384(1.1) të KPP sepse kolegji ishte në përbërje në shkelje të dispozitave ligjore të parapara në Ligjin Nr. 03/L-053 mbi Kompetencat, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë (më tutje “Ligji Nr. 03/L053”). Ky ligj nuk e parasheh mundësinë që një trup gjykues të përbëhet nga tre gjyqtarë të EULEX-it, dhe se marrëveshja ndërmjet Kryetarit të Gjyqtarëve të EULEX-it dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës nuk është e vlefshme sepse kjo është në kundërshtim me dispozitat ekzistuese ligjore.

36. Në fillim, Trupi Gjykues thekson që çështja në lidhje me trupin gjykues të përbërë nga 3 (tre) gjyqtarë të EULEX-it tashmë ishte ngritur nga mbrojtja dhe është trajtuar në hollësi në aktgjykimin e Gjykatës Themelore (shih paragrafët 15 dhe 16 të Gjykatës Themelore Aktgjykimi P 938/13 dhe faqe 24 e Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit PAKR 455/15). Të dy gjykatat konstatuan se edhe pse nuk është përcaktuar në Ligjin Nr. 03 / L053, përbërja e trupit gjykues nga tre gjyqtarë të EULEX-it është rezultat i kërkesave specifike të sigurisë dhe është e vetmja mënyrë për të siguruar të drejtën për gjykim të drejtë.

37. Kolegji vëren se Aktakuza në rastin konkret është ngritur më datë 8 nëntor 2013. Në atë kohë, juridiksioni dhe kompetencat e gjyqtarëve të EULEX-it në procedura penale ishte e rregulluar me Ligjin Nr. 03/L-053. Në përputhje me Nenin 3.2 të këtij Ligji, çdo çështje e hetuar apo ndjekur penalisht nga PSRK bie brenda juridiksionit të gjyqtarëve të EULEX-it. Më tej, në përputhje me Nenin 3.7 të Ligjit Nr. 03/L-053, Kolegjet në të cilat gjyqtarët e EULEX-it ushtrojnë juridiksionin e tyre në procedurat penale do të përbehen me shumicë të gjyqtarëve të EULEX-it dhe do të kryesohen nga një gjyqtar i EULEX-it.

38. Kolegji më tej vëren se më 30 maj 2014, Ligji Nr. 04/L-273 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjeve që Ndërlidhen me Mandatin e Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Republikën e Kosovës ka hyrë në fuqi *inter aliai* duke ndryshuar Ligjin 03/L-053 (më tutje “Ligji nr. 04/L-273”). Në përputhje me Nenin 2.3 të Ligjit mbi Kompetencat, më 18 qershor 2014, Shefi i EULEX Kosovo dhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës kanë nënshkruar një Marrëveshje mbi Aspektet e Rëndësishme të Aktivitetit dhe Bashkëpunimit të Gjyqtarëve të EULEX-it me Gjyqtarët e Kosovës. Konkretisht, Neni 5(a) i Marrëveshjes tregon se Gjyqtarët e EULEX-it do të sigurojnë që Gjykata Themelore në Mitrovicë mbetet operative derisa sistemi gjyqësor multi-etnik në Veri të implementohet dhe të jetë operativ. Prandaj, Marrëveshja tregon përpjekjet e vazhdueshme të EULEX-it dhe të KGJK-së në zgjidhjen e shqetësimeve të sigurisë në Gjykatën Themelore në Mitrovicë dhe të siguroj që rastet të gjykohen.
39. Për qëllim të nenit 14 të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike (më tutje “KNDCP” dhe nenit 6 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (më tej “KMDNJLTH), procedurat penale duhet të zhvillohen nga një “gjykatë e themeluar me ligj”. Ky kusht, sipas Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, shpreh parimin e sundimit të ligjit të pandarë në sistemin e GJEDNJ-së dhe protokollet e saj. Një organ që nuk është ngritur në përputhje me vullnetin e popullit, domethënë, siç shprehet me ligj, domosdo do t’i mungonte legjitimiteti që nevojitet në një shoqëri demokratike për një trup të tillë për të dëgjuar rastin e individëve. Edhe pse shprehja “e themeluar me ligj” nuk është përcaktuar në KNDCP ose në GJEDNJ, një nga elementet e tij thelbësore është kushti i kuadrit ligjor të rregulluar në mënyrë të mjaftueshme. GJEDNJ shton se nuk është e nevojshme të rregullohen të gjitha aspektet e gjyqësorit, për sa kohë që legjislacioni “krijon së paku kornizën organizative për organizatën gjyqësore”.<sup>1</sup>
40. Në rastin në fjalë, rregullat e përbërjes së kolegjit janë mjaftueshëm të rregulluara dhe mbulojnë kushtet themelore. Megjithatë, Ligji Nr. 04/L-273 nuk i adreson situatat e jashtëzakonshme, p.sh. kur kolegji nuk mund të përbëhet duke u bazuar në dispozitat e përcaktuara në Ligjin Nr. 04/L-273 për shkak të shqetësimeve të sigurisë. Marrëveshja e

---

<sup>1</sup> Zand v Austria [1978] komisioni Evropian për të Drejtat e Njeriut, paragrafët 69-70.

miratuar më 18 qershor 2014 manifeston përpjekjen e KGJK-së dhe të EULEX-it për të zgjidhur çështjen dhe të rregullojë këtë situatë specifike kur Gjykata Themelore në Mitrovicë do të bëhej jo-funksionale në rast se kushtet themelore të përcaktuara në Ligjin Nr. 04/L-273 do të ndiqeshin. Kjo orvatje ishte në përputhje me doktrinën e domosdoshmërisë që do të thotë “*përrjashtimi i një gjyqtari nuk duhet të kërkohet nëse nuk mund të formohet asnjë gjykatë tjetër për ta trajtuar rastin ose, për shkak të rrethanave urgjente, mosveprimi mund të çojë në një dështim të drejtësisë*”<sup>2</sup>

41. Prandaj, Kolegji konsideron se gjendja e sigurisë në Gjykatën Themelore të Mitrovicës është rrethanë e jashtëzakonshme që lejon të shmangemi nga kushti i përcaktuar në nenin 3.7 të Ligjit Nr. 04/L-273. Kolegji konsideron se nuk kishte zgjidhje tjetër të arsyeshme që do të kishte mundur lejimin e gjykimin të rastit në fjalë. Nëse trupi gjykues nuk do të përbëhej nga 3 (tre) gjyqtarë të EULEX-it, rasti do të ishte zvarritur tepër në dëm të të pandehurve. Prandaj, Kolegji konstaton se shmangia nga kushtet e përgjithshme për të zhvilluar procedurën penale nga një “gjykatë e themeluar me ligj” në rastin konkret është bazuar në rrethana të jashtëzakonshme për të siguruar të drejtën e të pandehurve për gjykim të drejtë dhe të shpejtë dhe është në përputhje me të drejtat e të pandehurve të përcaktuara në nenin 14 të KNDCP, nenin 6 të GJEDNJ dhe nenin 31 (2) të Kushtetutës së Kosovës. Rrjedhimisht, pretendimi i mbrojtësit të JD refuzohet si i pabazuar.

*- Procedurat në gjykatat e shkallës së parë dhe të dytë nuk ishin përfunduar brenda një afati të arsyeshëm*

42. Avokati mbrojtës i JD pretendon se aktgjykimi i kundërshtuar ka shkelë kushtet në ndjekjen e afateve procedurale siç përcaktohet në Nenet 5, 314(1) dhe 384(2) të KPP. I pandehuri ka qenë në paraburgim dhe në arrest shtëpiak që nga 23 maj 2013, por aktgjykimi i formës së prerë ende nuk është nxjerrë. Më tej, aktgjykimi i Gjykatës së Apelit i është dorëzuar të pandehurit vetëm 1 vjet e 5 muaj pas aktgjykimit të shkallës së parë.

43. Kolegji rikujton se në përputhje me Nenin 405(2) i KPP, Gjykata e Apelit duhet ta dërgoj vendimin e saj dhe ta parashtroj në Gjykatën Themelore jo më vonë se 3 (tre) muaj nga dita

---

<sup>2</sup> Komentari mbi Parimet e Bangalorit të Sjelljes Gjyqësore,  
[https://www.unodc.org/documents/corruption/publications\\_unodc\\_commentary-e.pdf](https://www.unodc.org/documents/corruption/publications_unodc_commentary-e.pdf), faqe 77.

kur ajo i ka pranuar shkresat e lëndës. Kolegji konfirmon se vendimi i Gjykatës së Apelit nuk ishte nxjerrë brenda afatit të përcaktuar në Nenin 405(2) i KPP.

44. Kolegji vëren se Gjykata e Apelit ka mbajtur seanca më 11, 12 dhe 13 Maj 2016 dhe ka mbajtur seancën këshilluese më 21, 26 korrik dhe më 15 Shtator 2016. Ky aktgjykim është i gjatë 57 faqe dhe përmban analizë detale të Krimeve të Luftës ndaj Popullatës Civile, përfshirë nocionin kompleks të përgjegjësisë komanduese, analizën e thukhtë faktike dhe ligjore të çdo pretendimi të ngritur nga të pandehurit dhe Prokuroria. Nuk ka asnjë indikacion se Gjykata e Apelit e ka vonuar aktgjykimin pa ndonjë arsye thelbësore. E kundërta, aktgjykimi është përgatitur, përfunduar dhe ju ka dorëzuar palëve në kohë të arsyeshme duke marrë parasysh shtrirjen e çështjes.
45. Në përputhje me nenin 6 të GJEDNJ, çdokush ka të drejtën e një gjykimi brenda një kohe të arsyeshme. Megjithatë, në vlerësimin e arsyeshmërisë së kohës, është e nevojshme që të vlerësohen rrethanat e secilit rast individual. Gjatë përcaktimit nëse kohëzgjatja e procedurave penale ka qenë e arsyeshme, Kolegji duhet të marrë në konsideratë faktorë të tillë si ndërlíkueshmëria e çështjes, sjellja e ankuesit dhe sjellja e autoriteteve përkatëse administrative dhe gjyqësore.<sup>3</sup> Rasti në fjalë është qartazi i gjatë dhe kompleks. Çështjet që Gjykata e Apelit i shqyrton kërkojnë hulumtime të detajuara mbi ligjin kombëtar dhe ndërkombëtar në fuqi, dhe kjo mori tre ditë këshillime për të arritur vendimin.
46. Prandaj, Kolegji konsideron se standardi i caktuar në Nenin 6 të GJEDNJ është plotësuar plotësisht edhe pse afati i përcaktuar në nenin 405(2) i KPP nuk është arritur. Më tej, Kolegji rikujton se sipas nenit 383(1) të KPP, duhet patjetër të vërtetohet se aktgjykimi i Gjykatës së Apelit përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale. Mbrojtja në rastin në fjalë nuk ia ka arritur të demonstrojë se shkelja e nenit 405(2) të KPP lidhur me afatet e përcaktuara ka shkelë të drejtat e mbrojtës dhe me gjasë ka ndikuar në nxjerrjen e një aktgjykimi të ligjshëm dhe të drejtë. Prandaj, pretendimi i avokatit mbrojtës të JD refuzohet si i pabazë.

---

<sup>3</sup> GJEDNJ, König kundër Gjermanisë, paragrafi 99; Neumeister kundër Austrisë, paragrafi 21; Ringeisen kundër Austrisë, paragrafi 110; Pélissier dhe Sassi kundër Francës [GC], paragrafi 67; Pedersen kundër Danimarkës, paragrafi 45.



*- Dispozitiv i pakuptueshëm dhe kontradiktor*

47. Mbrojtja e JD pretendon se aktgjykimi i kundërshtuar përmban shkelje të nenit 370(3) dhe 365 të KPK. Dispozitivi i aktgjykimit të Gjykatës së Apelit është i pakuptueshëm sepse ai nuk tregon se cila veprime i ka kryer i pandehuri JD, cili ishte personi ndaj të cilit i pandehuri gjoja ka përdorë dhunë, cilat ishin lëndimet dhe se a përbejnë ato veprime shkelje të rënda të Nenit 3 dhe 4 të përbashkët për të gjitha Konventat e Gjenevës.
48. Kolegji konsideron se dispozitivi i Aktgjykimit të Gjykatës Themelore është i përpiluar në përputhje me kushtet e parapara në Nenin 370 (3) dhe (4) lidhur me Nenin 365 të KPP. Dispozitivi përmban përshkrimin e plotë të veprimeve për të cilat të pandehurit janë shpallur fajtor apo janë liruar nga akuzat, së bashku me përshkrimin e fakteve dhe rrethanat që tregojnë natyrën e tyre penale dhe zbatimin e dispozitave përkatës të ligjit penal. Aktgjykimi i Gjykatës Themelore qartazi tregon rrethanat e veprës penale, përshkrim të qartë të veprës së kryer nga secili i pandehur, tregon cilat veprime janë kryer në bashkëkryerje dhe në mënyrë precize tregon emrat e palëve të dëmtuara. Dispozitivi në mënyrë të qartë përshkruan një mashkull të paidentifikuar nga treva e Shipolit në Mitrovicë. Më tutje, Kolegji thekson që aktgjykimi duhet të lexohet në tërësi duke përfshirë dispozitivin dhe arsyetimin. Dispozitivi dhe arsyetimi janë pjesë e pandashme e aktgjykimit dhe pjesë dhe/ose fjali të caktuara të aktgjykimit nuk mund të lexohen të veçuara.
49. Prandaj, Kolegji konsideron se avokati mbrojtës nuk ka dhënë ndonjë shkelje konkrete të Neneve 365(1)(1.1), 370(4) dhe 384(1.10) të KPP. Pretendimet për dispozitiv të mangët dhe kontradiktor janë më tepër të lidhur me mospajtimet me vërtetimin faktik. Kolegji vëren se situata faktike ndoshta e vërtetuar gabimisht nuk do të thotë automatikisht se aty ka ndonjë shkelje esenciale e procedurës penale. Këto janë dy baza të ndara të ankesës të cilat jo detyrimisht ndërlidhen. Prandaj, pretendimet e ngritura nga avokati mbrojtës i JD lidhur me dispozitivin e pakuptueshëm dhe kontradiktor refuzohen si të pabazuara.
50. Mbrojtja e JD pretendon se gjykata i ka tejkaluar akuzat. Dëshmitari deklaroi se rrahja e një personi të paidentifikuar nga Shipoli i Mitrovicës ka ndodhur vetëm një herë. Megjithatë, nga dispozitivi nuk është e qartë se a ka ndodhur rrahja vetëm një herë apo ka ndodhur në mënyrë të vazhdueshme që prej fillimit të Gushtit deri në fund të Shtatorit të vitit 1998.

51. Sa i përket kësaj, Kolegji konsideron se ky pretendim është më shumë keqkuptim i Aktgjykimit. Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit është një dokument i gjatë dhe kompleks i cili përmban një përshkrim të aspektit faktik dhe ligjor. Kjo mund të kërkoj një lexim të kujdesshëm dhe një vëmendje të madhe për detajet. Në këtë situatë konkrete, dispozitivi qartazi e thotë se “në një rast ndërmjet fillimit të Gushtit dhe fundit të Shtatorit 1998”. Lidhur me këtë, dispozitivi në mënyrë të qartë thekson se rrahja ka ndodhur në një rast, por koha kur ka ndodhur kjo rrahje është ndërmjet fillimit të Gushtit dhe fundit të Shtatorit 1998”. Kështu që, Kolegji konsideron se dispozitivi nuk është kontradiktor me veten dhe ai qartazi përcakton se për cilat veprime i pandehuri është shpallur fajtor apo i pafajshëm. Andaj, pretendimet e mbrojtjes refuzohen si të pabazuara.

*- Gjykata nuk e ka zbatuar ligjin më të favorshëm*

52. Mbrojta e JD pretendon se aktgjykimi i Gjykatës së Apelit është i paqartë dhe kundërthënës lidhur me cilësimin e veprës penale dhe ligjit në fuqi. Në dispozitiv, Gjykata e Apelit thekson se vepra penale është cilësuar në pajtim me Nenin 152(1) dhe (2)(2.1), (2.2) të KPP dhe Nenin 33(2) të Kushtetutës së Kosovës; megjithatë, arsyetimi i aktgjykimit nuk është i qartë dhe nuk specifikon se cilit ligj është zbatuar. Avokati mbrojtës i JD pretendon se sipas komentimit të Nenit 142 të KPRSFJ-së, vepra penale krim i luftës duhet të konsiderohet si një vepër e vetme penale pa marrë parasysh numrin e veprimeve individuale të ndërmarra.

53. Në rastin në fjalë, te dy gjykatat e kanë shqyrtuar çështjen e zbatimit të ligjit më të favorshëm. Gjykata Themelore i ka analizuar elementet e veprave penale të Krimeve të Luftës në Shkelje të Rëndë të Nenit 3 të Përbashkët të Konventave të Gjenevës, ashtu siç përshkruhet në Nenin 120 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (më tej “KPPK”) dhe Nenin 152 të KPK dhe Krime të Luftës kundër Popullatës Civile, siç është përshkruar në Nenin 142 të KPRSFJ dhe ka konstatuar se KPK duket të jetë ligji më i favorshëm sepse ai parasheh një dënim më të lehtë (*shih* paragrafët 248 – 281 të Aktgjykimit të Gjykatës Themelore P938/13). Në anën tjetër, Gjykata e Apelit ka konstatuar se arsyetimi i Gjykatës Themelore mbi të drejtën thelbësore të zbatueshme nuk është i qartë sepse Gjykata Themelore ka zbatuar KPRSFJ së bashku me KPK. Gjykata e Apelit e ka rivlerësuar zbatimin e ligjit më të favorshëm dhe ka konstatuar se dënimi i shqiptuar nuk mund të jetë

element i vetëm që duhet ta vlerësoj gjykata. Duke marrë parasysh faktin se koncepti i veprës penale në vazhdim nuk përfshihet nga KPRSFJ, por është përcaktuar në Nenin 81 të KPK, Gjykata e Apelit ka konstatuar se KPK është në fakt ligji më i favorshëm i zbatueshëm (shih faqe 46 – 49 në Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit PAKR 455/15).

54. Lidhur me ligjin penal të zbatueshëm, Kolegji është i ndërgjegjshëm për parimin e ligjshmërisë dhe të thelbit të tij e që është zbatimi i ligjit më të favorshëm ashtu siç parashihet në Nenin 2(2) të KPK dhe 3(2) të KPPK. Neni 11 i Deklaratës Universale të Drejtave të Njeriut (1948) jep një definicion të konstruktuar shumë mirë të parimit *“Askush nuk duhet të dënohet për veprime ose lëshime të cilat, në kohën kur janë kryer ato, nuk përbënin një vepër penale sipas ligjeve kombëtare a ndërkombëtare. Gjithashtu, nuk duhet të jepet një dënim më i rëndë se ai që ka mund të zbatohet në kohën kur është kryer vepra penale”*. Koncepti i njëjtë me formulimin thuajse identik gjendet në disa traktate ndërkombëtare dhe rajonale për të drejtat e njeriut, duke përfshirë Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike (1966), Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut. Me burim nga parimi i ligjshmërisë, koncepti i ligjit më të favorshëm penal është një mjet që garanton të drejtat individuale, duke siguruar kështu me efikasitetin e tij, qasjen dhe parashikueshmërinë e ligjit penal. Kur ekzistojnë dallime në mes të ligjit penal në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale dhe ligjeve penale pasuese të nxjerra para se të merret një vendim i formës së prerë, gjykatat duhet të zbatojnë ligjin dispozitat e të cilit janë më të favorshme për të pandehurin.<sup>4</sup>

55. Kolegji pajtohet me Gjykatën e Apelit se dispozitat e ligjit penal nuk mund të analizohet të veçuara. Identifikimi i ligjit penal më të favorshëm duhet të bëhet duke krahasuar dhe duke aplikuar ligjin në tërësinë e tij. Përgjithësisht pranohet që, për të përcaktuar ligjin më të favorshëm, është e nevojshme që të ekzaminohet dhe të krahasohet ligjet pasuese për sa i përket kushteve të penaltetit të veprës, ndjekjes penale dhe dënimit. Gjykata duhet të merr parasysh jo vetëm dënimin e paraparë për veprën penale por edhe të gjitha rregullat dhe institucionet lidhur me rastin dhe të cilat ndikojnë në përgjegjësinë penale të kryesit: unitetin dhe shumësinë e veprave penale, shkaqet e rëndimit dhe zbutjes së dënimit, dënimeve

---

<sup>4</sup> GJEDNJ, Scoppola kundër Italisë (nr. 2), paragrafët 103 – 109.

plotësuese dhe ndihmëse, dispozitave për tentativë, pjesëmarrja etj. Prandaj, Kolegji konsideron se në rastin e shumësisë së veprave penale, ekzistimi i konceptit të veprës penale në vazhdim do të ishte më i favorshëm për të pandehurin. Për këtë arsye, Gjykata e Apelit ka konstatuar drejtë se KPK është ligj më i favorshëm dhe duhet të jetë i zbatueshëm në rastin në fjalë.

56. Në kundërshtim me argumentet e mbrojtjes së JD, Gjykata e Apelit në mënyrë të qartë e ka sqaruar ligjin e zbatueshëm. Gjykata e Apelit më tutje ka sqaruar se shprehja *popullatë civile* përfshinë veprat penale të kryera ndaj individëve civilë sepse çdo civil paraqet tërësinë e popullatës civile. Arsyetimi i Gjykatës së Apelit në këtë aspekt është plotësisht në përputhje me komentimin e Nenit 142 të KPRSFJ të cituar nga mbrojtja. Prandaj, kolegji konsideron se pretendimet e avokatit mbrojtës të JD janë pa merita.

- *Koncepti i “dëshmitarit armiqësor” nuk lejohet në KPP*

57. Mbrojtja e JD pretendon se marrja në pyetje e dëshmitarëve ishte bërë në mënyrë të jashtëligjshme. Së pari, deklarimi i dëshmitarit si dëshmitar armiqësor (posaçërisht dëshmitarët L, C, I dhe F) është në kundërshtim me dispozitat e KPP. Prokurori ka bërë shumë pyetje drejtuese dhe kryetari i trupit gjykues në disa raste i ka ndihmuar Prokurorit. Kjo nuk është në përputhje me kushtin e barazisë së palëve dhe është në dëm të vërtetimit faktik.

58. Koncepti i dëshmitarit armiqësor në rastin në fjalë u paraqit nga Gjykata Themelore dhe në hollësi e ka diskutuar në aktgjykimin e saj. Gjykata Themelore konstatoi se edhe pse ky koncept nuk përfshihet në KPP, zbatimi i këtij koncepti është në përputhje me parimin e barazisë së palëve dhe modelin e përgjithshëm kundërshtues të procedurës penale (shih paragrafët 47-49 të Gjykatës Themelore Aktgjykimi P 938/13). Gjykata e Apelit në aktgjykimin e saj u pajtua me vlerësimin e Gjykatës Themelore (shih faqet 25-26 të Aktgjykimit të Apelit PAKR 455/15).

59. Dëshmitari armiqësor është një dëshmitar në shqyrtim gjyqësor dëshmia e të cilit në marrjen e drejtpërdrejt në pyetje është ose haptazi armiqësore ose duket të jetë në kundërshtim me pozitën ligjore të palës e cila e ka propozuar dëshmitarin. Ky koncept është kryesisht

reflektues i sistemit të së drejtës zakonore dhe ka dy komponentë kryesorë: mundësinë që pala propozuese ta merr në pyetje të tërthortë dëshmitarin e saj dhe të përdorë deklaratat e e dhëna në procedurë paraprake gjatë kësaj marrje të tërthortë në pyetje. Siç e kanë vërtetuar me të drejtë te dy gjykatat, ky koncept nuk përfshihet në KPP-në e tanishme. Prandaj, kolegji kthehet për të shqyrtuar nëse konceptet ligjore që nuk përfshihen në ligjin e zbatueshëm të procedurës penale mund të përdoren në rastin në fjalë dhe nëse përdorimi i koncepteve të tilla shkel të drejtat e të pandehurit.

60. KPP ekskluzivisht thotë që pala që e propozon dëshmitarin mundet vetëm të bëjë marrjen e drejtpërdrejt në pyetje (Shih Nenet 332(1) dhe 333 të KPK). Në të njëjtën kohë, palët tjera kanë të drejtë që dëshmitarin ta marrin drejtpërdrejt në pyetje siç është paraparë në nenet 332(2) dhe 334 të KPP. Në përgjithësi pyetjet duhet të përdoren në marrjen e drejtpërdrejt në pyetje; megjithatë, atyre ju lejohet marrja e tërthortë në pyetje. Më tej, në pajtim me Nenet 123(2) dhe 337(5) të KPP, deklaratat e mëparshme të dëshmitarit mund të përdoren gjatë marrjes së tërthortë në pyetje të atij dëshmitari. Prandaj, Kolegji gjen se deklaratat e mëparshme mund të përdoren në marrjen e tërthortë në pyetje për të kundërshtuar kundërthëniet e dëshmisë së dëshmitarit në shqyrtim kryesor. Natyrisht, kjo nuk do të thotë se deklaratat e mëparshme të dëshmitarit do të konsiderohen si dëshmi e drejtpërdrejt gjatë shqyrtimit gjyqësor përveç nëse plotësohen kushtet e parapara në Nenin 337 të KPP.
61. Tani Kolegji i kthehet çështjes se a mundet interesi i drejtësisë të diktoj një masë të caktuar të fleksibilitetit dhe se a është trupi gjykues në pozitë të lejojë palën e propozuar që të paraqesë deklaratën e mëparshme kontradiktore të dëshmitarit të saj me qëllim që të sq2aroj kontradiktat. Kolegji së pari vë në dukje se sistemi civil në përgjithësi nuk e ka konceptin e dëshmitarit armiqësor sepse tradicionalisht dëshmitarët thirren dhe merren në pyetje nën autoritetin e gjykatës, e cila i ka të gjitha deklaratat e mëparshme kontradiktore të dëshmitarit. Procedura e tanishme Penale e Kosovës e manifeston ndërveprimin e sistemeve kontradiktore dhe inkuizitor. Kodi i tanishëm i jep më shumë përgjegjësi palëve që të paraqesin rastin që kufizon ndikimin e gjykatës në shqyrtimin e provave. Sipas këtij kodi, gjyqtarët kanë rol të kufizuar në thirrjen dhe marrjen në pyetje të dëshmitarëve; përgjegjësitë e tyre kryesore kanë të bëjnë me mbrojtjen e të drejtave të palëve dhe menaxhimin e procedurës. Sidoqoftë, kodi aktual mbetet i heshtur përkitazi me atë se si të trajtohet situata

kur dëshmitari e tërheq deklaratën të cilën ai apo ajo e ka dhënë në fazën e procedurës paraprake.

62. Prandaj, në këtë situatë të veçantë, Kolegji është i mendimit se Gjykata Themelore ka ushtruar në mënyrë korrekte obligimin e saj për të udhëhequr procedurat penale dhe për të mbrojtur të drejtat e palëve duke trajtuar çështjen e dëshmitarit armiqësor. Duke lënë çështjen e dëshmitarëve që refuzuan deklaratën e tyre të dhëna në procedurën paraprake gjatë shqyrtimit gjyqësor do të kishte penguar jo vetëm interesin e palëve, por edhe kërkesa e gjykatave për të përmbushur qëllimet e drejtësisë. Gjykata Themelore, duke pasur parasysh rolin e gjyqtarit në kodin e tanishëm, zgjodhi të ndiqte modelin e sistemit kontradiktor, përkatësisht prezantimin e konceptit të dëshmitarit armiqësor.
63. Përderisa trupi gjykues në asnjë mënyrë nuk është i detyruar nga rregullat e të drejtës zakonore, është e rëndësishme të jeni të kujdesshëm në heqjen e masave të përgjithshme mbrojtëse që i përkasin procesit për arsye të drejtësisë ndaj palëve dhe me qëllim të vërtetimit të së vërtetës. Trupi gjykues është i mendimit se Gjykata Themelore ka marrë të gjitha masat e nevojshme, duke lejuar që pala thirrëse të marrë në pyetje të tërthortë dëshmitarin e vet. Gjykata Themelore fillimisht e trajtoi çështjen në hollësi, nëse dëshmitarët përkatës të shpallur si armiqësorë dhe trajtuan kundërshtimet e mbrojtjes (shih faqen 4, Procesverbali i shqyrtimit kryesor, 17 shtator 2014, Procesverbali i shqyrtimit kryesor, 24 korrik 2014, 5 gusht 2014, 17 shtator 2014 dhe 19 nëntor 2014). Gjykata Themelore ka përdorur diskrecionin e saj për kufizimin e shtrirjes së marrjes në pyetje dhe ka sqaruar pyetjet sipas nevojës. Prandaj, Trupi gjykues konsideron se Gjykata Themelore ka ruajtur me kujdes mbrojtjen e të drejtave të palëve.
64. Në fund, kolegji rikujton se shqyrtimi i apelit ka një fushëveprim të kufizuar. Në këtë situatë të veçantë, kolegji duhet të vlerësojë jo vetëm nëse Gjykata Themelore dhe Gjykata e Apelit kanë bërë ndonjë gabim ligjor, por gjithashtu edhe nëse koncepti i dëshmitarit armiqësor shkakton paragjykime ndaj palëve. Duhet të tregohet se vlerësimi i përgjithshëm i Gjykatës Themelore apo i Gjykatës së Apelit nuk ka arritur të sjellë drejtësi. Në rastin në fjalë, Gjykata Themelore largon katër dëshmitarë të Prokurorisë (Dëshmitarët C, I, L dhe F)

si dëshmitarë armiqësorë. Dëshmitë e tyre në procedurë paraprake u përdorën në marrjen e tërthortë në pyetje të udhëhequr nga Prokuroria. Trupi gjykues thekson se kjo është përdorur vetëm për të përcaktuar kredibilitetin e dëshmitarëve. Gjykata Themelore i ka shpallur dëshmitë e katër dëshmitarëve armiqësorë si dëshmi jo të besueshme dhe nuk i ka marrë parasysh dëshmitë e tyre gjatë përcaktimit të fajësisë të të pandehurve (shih paragrafët 189 deri 200 të Aktgjykimit të Gjykatës Themelore P 938/13). Prandaj, Trupi gjykues konsideron se të pandehurit nuk kanë treguar se si përdorimi i konceptit të dëshmitarit armiqësor shkakton ndonjë paragjykim ndaj tyre dhe shpall pretendimet e tyre jo meritore.

- *Gjykimet e kontestuara bazohen në mënyrë të gabuar në dëshminë e një dëshmitari*
65. Mbrojtja e JD dhe SS pretendon se aktgjykimi i kundërshtuar ka shkelur nenin 2 të KPP-së, sepse rasti nuk ishte gjykuar në mënyrë të paanshme dhe të pavarur. Tërë aktgjykimi bazohet vetëm në dëshminë e Dëshmitarit A dhe dëshmia e tij nuk mbështetet nga asnjë provë tjetër.
66. Gjykata e Apelit ka trajtuar në hollësi nëse dënimi do të mund të bazohet në dëshminë e një dëshmitari. Gjykata e Apelit konkludoi qartë se asnjë nga situatat e përshkruara në nenin 262 të KPP-së nuk kanë ndodhur; Prandaj dënimi mund të bazohet në dëshminë e një dëshmitari edhe pse pragu për vlerësimin e kredibilitetit të këtij dëshmitari duhet të jetë më i lartë (shih faqen 31 të Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit PAKR 455/15).
67. Trupi gjykues rikujton se në pajtim me nenin 262 (3) dhe (4) të KPP-së, dëshmia e një dëshmitari nuk mund të përdoret si bazë për fajësinë e të pandehurit nëse identiteti i dëshmitarit është anonim për të pandehurin dhe mbrojtësin e tij, dhe nëse dëshmitari i vetëm ka statusin e dëshmitarit bashkëpunues. Ashtu siç ka vërtetuar Gjykata e Apelit, asnjë nga kufizimet e përshkruara në nenin 262 të KPP-së nuk është i zbatueshëm për rastin në fjalë. Kjo tregon qartë se ligji lejon një vendim fajësues duke u mbështetur në dëshminë e një

dëshmitari që identifikon të pandehurin si personin që ka kryer krimin për të cilin akuzohet. Kjo praktikë është në përputhje me jurisprudencën e gjykatave ndërkombëtare.<sup>5</sup>

68. Avokati mbrojtës i JD dhe SS nuk pajtohet me konkluzionin e Gjykatës së Apelit se ligjvënësi lejon që një i pandehur të konsiderohet fajtor bazuar në dëshminë e një dëshmitari. Dispozitat e KPP-së që rregullojnë situatën në të cilën i pandehuri nuk mund të shpallet fajtor në bazë të dëshmisë së një dëshmitari, janë të rregulluara qartë; Megjithatë, ato nuk janë të zbatueshme në këtë rast. Prandaj, Trupi gjykues konsideron se mbrojtja është mjaft sfiduese nëse dëshmitë e paraqitura nga Dëshmitari A ishin të mjaftueshme për të përcaktuar fajësinë e të pandehurit JD dhe SS.
69. Trupi gjykues pajtohet me mbrojtjen se dëshmitë e dëshmitarit të vetëm duhet të vlerësohen në dritën e provës së mjaftueshmërisë. Në vlerësimin nëse dëshmitë e drejtpërdrejta të dëshmitarit mund të jenë të mjaftueshme për vërtetimin e fajësisë së të pandehurit, aspekti më i rëndësishëm është besueshmëria. Prandaj, Trupi gjykues konsideron se pretendimi i mbrojtjes se gjykatat e shkallës së parë dhe të shkallës së dytë nuk mund ta bazojnë vendimin fajësues në dëshminë e një dëshmitari ka të bëjë më shumë me mospajtimin me vërtetimin faktik. Trupi gjykues thekson se situata faktike e mundshme e vërtetuar gabimisht ose në mënyrë jo të plotë nuk nënkupton automatikisht se ekziston një shkelje substanciale e procedurës penale. Këto janë dy arsye të veçanta të një apeli, të cilat nuk janë domosdo të ndërlydhura. Prandaj, ky pohim refuzohet si i pabazuar dhe mospajtimi i mbrojtjes në lidhje me dëshminë e Dëshmitarit A do të trajtohet më poshtë.

- *Shqyrtimi de novo i gabuar*

---

<sup>5</sup> *Shih*, Aktgjykimi i Apelit Muhimana, paragrafi 101; Aktgjykimi i Apelit Gacumbitsi, paragrafi 72; Aktgjykimi i Apelit Semanza, paragrafi 153; Limaj et al. Aktgjykimi i Apelit, paragrafi 203; Kvoika et al. Aktgjykimi i Apelit, paragrafi 5761; Aktgjykimi i Apelit Tadic, paragrafi 65.



70. Mbrojtja e SS pretendon se Gjykata e Apelit ka kryer një shqyrtim të gabuar *de novo* të fakteve pa sqaruar se pse gjetjet e Gjykatës Themelore ishin të paarsyeshme. Në gjykatat ndërkombëtare është pranuar se Gjykata e Apelit nuk mund të zëvendësojë pikëpamjen e vet për provat dhe gjetjet faktike për atë të gjykatës së gjykimit, përveç nëse një vërtetues i arsyeshëm faktik nuk do të kishte arritur një vendim fillestar. Konkretisht, konkluzioni i Gjykatës së Apelit në lidhje me kushtet e ndalimit bazohet në supozime.
71. Në fillim, Trupi gjykues thekson se standardet e shqyrtimit të ankesave nxirren nga dhe, deri në një masë reflektojnë rolin e kufizuar të gjykatës së apelit në një sistem gjyqësor me shumë nivele. Si rregull i përgjithshëm, gjyqtarët e apelit kanë të bëjnë kryesisht me korrigjimin e gabimeve ligjore të bëra nga gjykatat më të ulëta, zhvillimin e ligjit dhe përcaktimin e precedentit që do të udhëheqë rastet e ardhshme. Gjyqtarëve të Gjykatës Themelore, përkundrazi, u janë besuar roli i zgjidhjes së mosmarrëveshjeve faktike relevante dhe i marrjes së vendimeve të besueshmërisë në lidhje me dëshmitë e dëshmitarëve, sepse ata i shohin dhe dëgjojnë dëshmitarët. Gjetjeve faktike të një gjyqtari në gjykim respektohen shumë sepse gjyqtari ka kryesuar gjykimin, ka dëgjuar dëshminë dhe kupton më së miri provat. Sipas standardit qartë të gabuar, nuk mjafton të tregohet se vërtetimi faktik ishte i diskutueshëm. Një gjykatë e apelit do të pohojë vërtetimin e fakteve të gjykatës nëse, bazuar në një shqyrtim të të gjithë procesverbalit, përveç nëse nuk e ka bindjen e përcaktuar dhe të vendosur se është bërë një gabim. Dallimi i gjerë i respektimit u konfirmua edhe nga Gjykata Supreme në rastet e mëparshme *“respektimi i vlerësimit nga trupi gjykues i kredibilitetit të dëshmitarëve të gjykimit të cilët u paraqitën personalisht para tyre dhe që dëshmuan personalisht para tyre. Nuk është e përshtatshme që Gjykata Supreme e Kosovës mos të pranojë vlerësimin e Trupit Gjykues lidhur me besueshmërinë e këtyre dëshmitarëve përveç nëse ka një bazë të shëndoshë për të vepruar kështu. “Standardi i aplikuar nga Gjykata Supreme ishte “të mos trazojë gjetjet e gjykatës, përveç nëse dëshmitë e mbështetura nga gjykata nuk mund të pranoheshin nga ndonjë gjykatë e arsyeshme e fakteve ose kur vlerësimi i saj ishte tërësisht i gabuar”*.<sup>6</sup>

---

<sup>6</sup> Gjykata Supreme e Kosovës, AP-KZi 84/2009, 3 dhjetor 2009, paragrafi 35; Gjykata Supreme e Kosovës, AP-KZi 2/2012/2} 24 shtator 2012, paragrafi 30

72. Standardi i shqyrtimit të apelit për vërtetimin faktik është përcaktuar në nenin 386 të KPP-së. Ky nen e konfirmon se nuk mjafton që të kundërshtohet aktgjykimi vetëm duke e treguar gabimin e pretenduar ose vërtetimin jo të plotë të fakteve nga trupi gjykues. Përkundrazi, meqenëse kodi i procedurës penale kërkon që vërtetimi i gabuar ose jo i plotë i gjendjes faktike lidhet me një “fakt material”, ankuesi duhet gjithashtu të vërtetojë se vërtetimi i gabuar ose jo i plotë i gjendjes faktike ka të bëjë me një fakt material, d.m.th. është kritik për vendimin e arritur.
73. Prandaj, Trupi gjykues pajtohet me mbrojtjen e SS se standardi *de novo* nuk mund të përdoret në lidhje me faktet. Megjithatë, trupi gjykues më tutje thekson se Gjykata e Apelit nuk pajtohet me Gjykatën Themelore për besueshmërinë e Dëshmitarëve B dhe D (shih faqet 35-38 të Aktgjykimit të Apelit PAKR 455/15). Gjykata e Apelit nuk ka kryer një shqyrtim *de novo*, gjykata më tepër vlerësoi deklaratën e dëshmitarëve të dhënë në shqyrtimin kryesor dhe në kundërshtim me Gjykatën Themelore arriti në përfundimin se kontradiktat në këto deklarata janë shumë të ashpra për t’i konsideruar ato si të besueshme. Prandaj, Trupi gjykues konsideron se në shqyrtimin e pretendimeve faktike, Gjykata e Apelit ka zbatuar në mënyrë të drejtë standardin qartë të gabuar.
74. Megjithatë, ndryshimi i lirimeve bëhet thjesht bazuar në interpretimin e ligjit. Çështjet e ligjit janë shqyrtuar *de novo*. Sepse gjatë shqyrtimit të ankesës, gjykatat janë kryesisht merren me shpalljen e ligjit, ato nuk i kushtojnë vëmendje vlerësimit të gjykatës për çështje thjesht ligjore. Në lidhje me këtë, në përcaktimin e fajësisë së të pandehurve në lidhje me Pikën IV të aktakuzës, Gjykata e Apelit i trajtoi thjesht çështjet juridike të elementeve të krimeve të luftës. Prandaj, Trupi gjykues konsideron se Gjykata e Apelit ka aplikuar standarde korrekte të shqyrtimit në lidhje me vërtetimin faktik dhe ligjor të bërë nga Gjykata Themelore. Prandaj, pretendimet e avokatit mbrojtës të SS refuzohen si të pabazuara.

75. Mbrojtja e JD dhe SS pohojnë se Gjykata e Apelit gabimisht arriti në përfundimin se deklaratat e Dëshmitarit A janë të besueshme dhe të mbështetura nga dëshmia e Dëshmitarit K dhe eksperti CB. Deklaratat e këtij dëshmitari janë kontradiktore dhe nuk mund të provojnë ndonjë fakt apo rrethanë relevante, siç është koha kur ai u soll në paraburgim, sa kohë qëndroi atje, kohën kur u keqtrajtua, nivelin e keqtrajtimit, pasojat ndaj shëndetit të tij, identiteti i anëtarëve të familjes së tij nuk u vërtetua kurrë. Mbrojtja pretendon se Gjykata e Apelit nuk ka arritur të vlerësojë faktorë të tjerë në lidhje me dëshmitë e Dëshmitarit A. Në veçanti, fakti se dëshmitari ishte diagnostikuar me psikozë akute dhe kishte arsye të forta materiale për të qenë pjesë e programit të mbrojtjes së dëshmitarëve.
76. Dëshmia e dëshmitarit A ishte kontradiktore me atë që ai dha në një rast tjetër – Drenica II. Për shembull, mbrojtja e JD pohon se në atë rast dëshmitari deklaroi se kurrë nuk e ka parë JD në dhomën e vogël.
77. Në lidhje me rrahjen e një personi të paignifikuar nga zona e Shipolit në Mitrovicë (Pika IV), Dëshmitari A nuk ishte i sigurt për kohën që të ndaluarit tjerë qëndronin në dhomën e tij; ai nuk i dinte arsyet pse u sollën apo kush i solli ata. Dëshmitari më tej nuk ishte në gjendje të identifikonte kohën kur ndodhi rrahja. Më tej, dëshmitari nuk ishte i sigurt për sa kohë tre vëllezërit qëndruan në dhomën e tij. Mbrojtja e SS shton se në fillim Dëshmitari A dëshmoi se vetëm JD mori pjesë në rrahje, ndërsa më vonë për shkak të pyetjeve orientuese, dëshmitari ndryshoi deklaratën e tij dhe shtoi se SS gjithashtu mori pjesë në rrahje.
78. Dëshmia e Dëshmitarit D u deklarua si jo e besueshme për shkak të llojit të njëjtë të kontradiktave si në dëshminë e Dëshmitarit A. Kështu, gjykatat aplikuan standarde të ndryshme ligjore.
79. Gjykata Themelore dhe Gjykata e Apelit trajtuan çështjen e besueshmërisë së dëshmisë së Dëshmitarit A gjerë e gjerë (shih paragrafët 109 deri 119 të Aktgjykimit të Gjykatës

Themelore P 938/13 dhe faqet 31-33 të Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit PAKR 455/15). Të dy gjykatat konkluduan se shpjegimet e përgjithshme të Dëshmitarit A duket të jenë konsistente dhe koherente, prandaj të dy gjykatat deklaruan dëshminë e Dëshmitarit A si plotësisht të besueshme. Për më tepër, Gjykata e Apelit i adresoi të gjitha pretendimet e mbrojtjes të ngritura në ankesat e tyre, përkatësisht sëmundjen mendore të dëshmitarit, kërkesën e tij për të marrë statusin e veteranit të UÇK-së dhe mospërputhjet në dëshmi të pretenduara nga mbrojtja, shpjegoi qartë çdo pretendim dhe arsyen pse mbrojtja nuk arriti të tregojë një gabim në vlerësimin faktik të bërë nga Gjykata Themelore.

80. Trupi gjykues përkujton standardin e shqyrtimit të ankesës në lidhje me vërtetimin faktik siç është detajuar në kapitullin e mëparshëm të këtij aktgjykimi. Më tej, Trupi gjykues përkujton se Gjykata Themelore ka fuqi të plotë diskrecionale për përcaktimin e peshës dhe kredibilitetit të duhur që duhet t'i akordohet dëshmisë së një dëshmitari. Ky vlerësim bazohet në një numër faktorësh, duke përfshirë sjelljen e dëshmitarit në gjykatë, rolin e tij në ngjarjet në fjalë, besueshmërinë dhe qartësinë e dëshmisë së tij, nëse ka kontradikta ose mospërputhje në deklaratat e tij të njëpasnjëshme apo midis dëshmisë së tij dhe provave të tjera, shembuj të mëparshëm të dëshmisë së rreme, ndonjë arsye për të gënjyer, dhe përgjigjet e dëshmitarit gjatë marrjes në pyetje. Më tej, trupi gjykues përkujton se Gjykata Themelore ka përgjegjësinë kryesore për të zgjidhur çdo mospërputhje që mund të lind brenda ose midis dëshmive të dëshmitarëve. Është në diskrecionin e Gjykatës Themelore të vlerësojë çdo mospërputhje të tillë, të shqyrtojë nëse provat e marra janë të besueshme si tërësi dhe të pranojë ose refuzojë karakteristikat themelore të provave. Nuk është gabim ligjor në vetvete të pranohen dhe të mbështetet në prova që devijojnë nga një deklaratë paraprake ose prova të tjera të paraqitura në gjykim. Megjithatë, trupi gjykues është i detyruar të marrë parasysh çdo shpjegim të ofruar në lidhje me mospërputhjet kur peshon vlerën provuese të provave.

81. Nga ana tjetër, pala që kundërshton një vendim diskrecional nga trupi gjykues duhet të tregojë se Gjykata Themelore ka bërë një gabim të dukshëm. Vendimi diskrecional i Gjykatës Themelore mund të përmbysset vetëm kur vërtetohet se: (1) është i bazuar në një interpretim të pasaktë të ligjit qeverisës; (2) është i bazuar në një përfundim të gabuar të

fakteve; ose (3) është aq i padrejtë ose i paarsyeshëm sa të përbëjë një keqpërdorim të diskrecionit.<sup>7</sup>

82. Në rastin në fjalë, shumica e anëtarëve të kolegjit konsideron se nuk ka asnjë indikacion i cili tregon se si Gjykata Themelore ose Gjykata e Apelit nuk kanë arritur të vlerësojnë deklaratën e Dëshmitarit A, ose si mospërputhjet e veçanta të ngritura nga mbrojtja do të mund të rezultonin në kthimin ose rishikimin e dy aktgjykimeve. Shumica e anëtarëve të kolegjit konsideron se mospërputhjet e tilla si fakti që Dëshmitari A nuk ka qenë i sigurt nëse FM dhe HP ishin të pranishëm kur njëri prej vëllezërve ishte rrahur, do të shpinte Gjykatën Themelore ose Gjykatën e Apelit drejt marrjes së një vendimi tjetër në lidhje me kredibilitetin e Dëshmitarit A. Më tej, është e rëndësishme të theksohet se deklaratat e veçanta të dëshmisë së dëshmitarit nuk mund të vlerësohen në mënyrë të izoluar. Për shembull, mbrojtja pretendon se Dëshmitari A ishte kontradiktor, kur deklaroi se tre vëllezërit nga Shipoli qëndruan në paraburgim për 3-4 orë, derisa më vonë ai ndryshoi dëshminë e tij dhe pohoi se të tre vëllezërit qëndruan në paraburgim gjatë natës. Shumica e anëtarëve të trupit gjykues konsiderojnë se kjo deklaratë është nxjerrë jashtë kontekstit, ndërsa është e qartë se dëshmitari flet për tre vëllezërit që qëndruan në paraburgim gjatë natës (shih faqen 24 të Procesverbalit të shqyrtimit kryesor, 25 qershor 2014 dhe faqe 20 e Procesverbalit të shqyrtimit kryesor, 18 korrik 2014).

83. Shumica e anëtarëve të trupit gjykues konsideron se Dëshmitari A prezantoi në përgjithësi një përshkrim të hollësishëm të ngjarjeve, dëshmia e tij iu nënshtroi marrjes së tërthortë në pyetje nga ana e të gjithë të pandehurve (shih Procesverbalin e shqyrtimit kryesor, 24, 25 qershor 2014, dhe 8, 16, 17, 18 korrik 2014). Shpjegimet e tij ishin të qëndrueshme në pjesët më të rëndësishme të dëshmisë së tij. Shumica e anëtarëve të trupit gjykues është e ndërgjegjshme se ekzistojnë disa kontradikta në mes të deklaratave të Dëshmitarit A. Në kundërshtim me parashtrirat e të gjithë avokatëve mbrojtës, këto kontradikta janë përgjithësisht të vogla dhe nuk vënë në pikëpyetje vendimin e Gjykatës Themelore dhe të

---

<sup>7</sup> ICTY, POPOVIĆ et al.(IT-05-88-A), Aktgjykimi i Apelit, 30.01.2015, paragrafi 131.

Gjykatës së Apelit për t'u mbështetur në shpjegimet e Dëshmitarit A. Së fundi, Shumica e anëtarëve të trupit gjykues konsiderojnë se Gjykata e Apelit ka marrë në konsideratë saktë sëmundjen e pretenduar të Dëshmitarit A dhe faktin se ai u përpoq të regjistrohej si veteran i UÇK-së.

84. Më tej, Trupi gjykues thekson se deklaratat e dhëna nga Dëshmitari A në raste të tjera nuk kanë qenë kurrë pjesë e këtij procesi gjyqësor. Prandaj, trupi gjykues nuk do të trajtojë asnjë pretendim në lidhje me deklaratat e Dëshmitarit A të dhëna në raste të tjera.

- *Elementet e krimeve të luftës nuk janë vërtetuar plotësisht (Pika IV)*

85. Në lidhje me Pikën IV, mbrojtja e SS pohon se jo të gjitha shkeljet e integritetit trupor, dinjitetit ose shëndetit përbëjnë krim lufte. Duhet të dëshmohet vuajtja fizike ose mendore. Lëndimet e personit të paidentifikuar nga zona e Shipolit në Mitrovicë nuk janë identifikuar asnjëherë nga Dëshmitari A. Arsytimi i Gjykatës së Apelit bazohet në spekulime dhe mendime subjektive, prandaj duhet të anulohet.

86. Kjo çështje, nëse është e nevojshme që të provohet vuajtja fizike për të përcaktuar se një veprim duhet të konsiderohet si shkelje e rëndë e Nenit 3 të përbashkët për Konventat e Gjenevës është trajtua nga Gjykata Themelore dhe Gjykata e Apelit. Gjykata Themelore arriti në përfundimin se është e nevojshme të provohen pasojat e rënda për viktimën. Në rastin aktual, niveli i seriozitetit të rrahjes së njeriut të panjohur nga zona e Shipolit nuk ka arritur pragun e nevojshëm të seriozitetit (shih paragrafët 239-244.2 dhe 282-289 të Aktgjykimit të Gjykatës Themelore P 938/13). Gjykata e Apelit ka shprehur mospajtimin e saj me vlerësimin e Gjykatës Themelore. Në vlerësimin e shkeljes së rëndë të së drejtës ndërkombëtare humanitare, është e nevojshme të vlerësohen kushtet e përgjithshme. Dëmi i drejtpërdrejtë trupor i shkaktuar ndaj viktimës ose dëmtimi i përhershëm i shëndetit nuk është e vetmja gjë që duhet marrë parasysh (shih faqet 51-52 të Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit PAKR 455/15). Prandaj, Gjykata e Apelit e anuloi lirimin nga akuza lëshuar nga Gjykata Themelore dhe gjeti të pandehurit SS dhe JD për veprën penale siç përshkruhet në Pikën IV.

87. Statutet e Tribunalit Ndërkombëtar parashohin që vetëm shkeljet "e rënda" të ligjeve dhe zakoneve të krimeve të luftës brenda juridiksionit të tyre mund të rezultojnë në përgjegjësi penale individuale në përputhje me statutet e tyre. Një shkelje e DNH është e rëndë nëse përbën shkelje të një "rregulle që mbron vlerat e rëndësishme dhe shkelja duhet të ketë pasoja të rënda për viktimën". Të gjitha shkeljet e rënda të Konventave të Gjenevës konsiderohen si shkelje të rënda të DNH-së. Është praktikë e pranuar në përgjithësi e tribunaleve ndërkombëtare që në mënyrë që kërkesa e gravitetit të përmbushet, shkelja që bëhet duhet të jetë e rëndë, domethënë, duhet të përbëjë një shkelje të një rregulle që mbron vlerat e rëndësishme dhe shkelja duhet të përfshijë pasoja të rënda për viktimën.<sup>8</sup> Gjykata Themelore dhe Gjykata e Apelit u pajtuan për këtë praktikë të themeluar; Megjithatë, ato nuk ishin pajtuar lidhur me shkallën e shkakimit të dëmit ndaj viktimës dhe nëse është e mundur të përcaktohet dëmi i tillë bazuar në faktet e vendosura në rastin në fjalë.

88. Në rastin në fjalë, neni 152 (2) (2.1) dhe (2.2) i KPK-së përcakton krimet e luftës si shkelje të rënda të nenit 3 të përbashkët të katër Konventave të Gjenevës si më poshtë:

2. Shkelje e rëndë e nenit 3, të përbashkët për të katër Konventat e Gjenevës të 12 gushtit 1949, do të thotë një ose më shumë nga veprat e mëposhtme të kryera në kontekstin e një konflikti të armatosur jo të një karakteri ndërkombëtar kundër personave që nuk marrin pjesë aktive në armiqësi, duke përfshirë edhe pjesëtarët e forcave të armatosura që i kanë dorëzuar armët dhe që nuk janë në gjendje të luftojnë për shkak të sëmundjes, plagëve, ndalimit ose për ndonjë shkak tjetër:

2.1. dhuna ndaj jetës dhe personit, në veçanti vrasja e çdo lloji, gjymtimi, trajtimi mizor dhe tortura;

2.2. kryerja e akteve fyese ndaj dinjitetit të personit, në veçanti poshtërimi dhe trajtimi nënçmues;

89. Në praktikën e gjykatave ndërkombëtare, trajtimi jonjerëzor ose mizor përcaktohen si një veprim i qëllimshëm ose mosveprim, i cili shkakton dëmtim të rëndë mendor ose vuajtje fizike ose dëmtim ose përbën një sulm të rëndë ndaj dinjitetit njerëzor dhe që kryhet kundër

---

<sup>8</sup> TNKLIJ, TADIĆ Duško (IT-94- 1-AR72), Vendim i Përkohshëm mbi Juridiksionin - 02.10.1995, paragrafët 94; Kunarac, Kovac dhe Vokovic, (Dhoma e Apelit), 12 qershor 2002, para. 66; ee si dhe Prokurori kundër Kvočka et al., Rasti Nr. IT-98- 30/1 (Dhoma e Shqyrtimit), 2 nëntor 2001, para. 123.

personit të mbrojtur.<sup>9</sup> Shkalla e vuajtjes fizike ose mendore që kërkohet për të provuar trajtimin çnjerëzor ose trajtimin mizor është më e ulët se ajo që kërkohet për torturë, por në të njëjtin nivel me atë që shkakton qëllimisht vuajtje të mëdha ose lëndime të rënda për trupin ose shëndetin si një shkelje e rëndë e Konventave të Gjenevës. Për shembull, kushtet e dobëta në kampet e burgjeve mund të konsiderohen si trajtim mizor.<sup>10</sup> Trajtimi poshtërues dhe degradues është më i gjerë se tortura, trajtimi çnjerëzor dhe shkakton vuajtje të mëdha ose lëndim të rëndë. Qëllimi është mbrojtja e personave nga poshtërimi dhe tallja, më shumë se nga dëmtimi i integritetit dhe mirëqenies fizike dhe mendore të personave. Krimi duhet të përmbushë një nivel objektiv të caktuar të peshës për t'u konsideruar si një shkelje për dinjitetin personal. Poshtërimi duhet të jetë aq i rëndë sa që çdo person i arsyeshëm do të cenohej.<sup>11</sup> Për të përcaktuar këtë, faktorët për shqyrtim përfshijnë formën, ashpërsinë dhe kohëzgjatjen e dhunës, dhe intensitetin dhe kohëzgjatjen e vuajtjes fizike ose mendore.

90. Gjykata Themelore dhe Gjykata e Apelit u pajtuan për zbatimin e të Drejtës Ndërkombëtare Humanitare dhe se është e nevojshme të tregohen pasojat e rënda për viktimën në mënyrë që të përcaktohet nëse aktet e të pandehurve përbënin shkelje të rëndë të nenit të përbashkët 3 për katër Konventat e Gjenevës. Përcaktimi i seriozitetit të dëmit në fjalë duhet të bëhet rast pas rasti duke vlerësuar provat e paraqitura gjatë shqyrtimit kryesor. Në lidhje me këtë, Gjykata Themelore dhe Gjykata e Apelit nuk u janë pajtuar për vlerësimin e lëndimeve të shkaktuara.

91. Në këtë rast, Gjykata e Apelit arriti në përfundimin se për të përcaktuar nëse personi i paidentifikuar nga zona e Shipolit në Mitrovicë ka pësuar trajtim mizor ose trajtim poshtërues dhe degradues, është e nevojshme të adresohen rrethanat e përgjithshme. Gjykata e Apelit ka konstatuar se ekzistonte një qendër paraburgimi në Likoc, ku kishte disa të paraburgosur të mbajtur në kushte të këqija (shih faqet 43-44 të Aktgjykimit të Apelit PAKR

---

<sup>9</sup> TNKLIJ, Naletilid, Aktgjykimi nga Gjykata, paragrafët 246; Čelebidi, Aktgjykimi i Apelit, paragrafi 426.

<sup>10</sup> TNKLIJ, Limaj, Aktgjykimi nga Gjykata, paragrafët 288 – 289.

<sup>11</sup> TNKLIJ, *Kunarac*, Aktgjykimi i Apelit, paragrafi 162.



455/15). I paraburgosuri ishte rrahur para vëllezërve të tij dhe njerëzve të tjerë (të paktën Dëshmitari A); ai ishte rrahur për një periudhë të konsiderueshme kohore duke përdorur grushte dhe shqelma (shih faqen 24 të procesverbalit të shqyrtimit kryesor, 25 qershor 2014).

92. Shumica e trupit gjykues pajtohet me Gjykatën e Apelit se rrethanat e përgjithshme tregojnë qartë se personi i paidentifikuar nga zona Shipol në Mitrovicë është mbajtur në kushte të këqija për një kohë të konsiderueshme; Ai ishte marrë në pyetje nga SS dhe më vonë është rrahur nga SS dhe JD. Një trajtim i tillë përbën qartë trajtimin mizor dhe trajtimin poshtëruës dhe degradues siç është përcaktuar në nenin 152 (2) (2.1) dhe (2.2) të KPK-së. Personi i paidentifikuar nga zona e Shipolit në Mitrovicë ka përjetuar vuajtje të madhe fizike dhe mentale, dëmtim të integritetit të mirëqenies fizike dhe mendore. Për më tepër, dëmi serioz mendor nuk duhet të rezultojë nga veprime që shkaktojnë dëmtime të përhershme ose të pandreqshme mendore; mjafton që sjellja e dëmshme të shkaktojë dëmtim të rëndë dhe afatgjatë të aftësisë për të jetuar një jetë normale. Në rastin në fjalë, tre vëllezërit nga zona e Shipolit në Mitrovicë u ndaluan për shkak të bashkëpunimit të pretenduar me serbët, ata u mbajtën në paraburgim dhe u rrahën për një kohë të konsiderueshme. Shumica e trupit gjykues është e mendimit se kjo tregon se njeriu i paidentifikuar nga zona e Shipolit në Mitrovicë nuk vuante vetëm nga dhuna fizike, por ishte gjithashtu i ekspozuar ndaj kërcënimit të vazhdueshëm të dhunës që do të zgjaste edhe pas lirimimit nga qendra e ndalimit. Prandaj, trupi gjykues konsideron që Gjykata e Apelit ka vlerësuar saktë pasojat e rënda ndaj viktimës dhe ka vërtetuar saktë se rrahja e një burri nga zona e Shipolit në Mitrovicë korrespondon me shkeljen e rëndë të nenit 3 të përbashkët për katër Konventat e Gjenevës. Për këtë arsye, pretendimet e avokatit mbrojtës lidhur me Pikën IV hedhen si të pabazuara.

- *Aktakuza nuk ka ngarkuar të pandehurit me përgjegjësi komanduese*

93. Mbrojtja e SS pretendon se i pandehuri nuk mund të shpallet fajtor për Pikën IX nën teorinë e përgjegjësisë komanduese, sepse kjo mënyrë e përgjegjësisë nuk ishte trajtuar asnjëherë nga trupi gjykues. Aktakuza kurrë nuk e ka ngarkuar SS me përgjegjësi komanduese. Mbrojtja pretendon se SS ishte akuzuar si bashkëkryerës për këtë vepër penale; Prandaj i pandehuri nuk kishte shans që të kundërshtonte konceptin e përgjegjësisë komanduese.

94. Trupi gjykues thekson që Aktakuza në lidhje me të pandehurit SL dhe SS thotë si më poshtë “i pandehuri, në cilësinë e tij si anëtar i UÇK-së dhe si person që ushtron kontroll mbi qendrën e paraburgimit në Likoc” (shih faqet 12 dhe 13 të Aktakuzës PPS 88/11). Në këtë drejtim, trupi gjykues nuk pajtohet me mbrojtjen e SS se i pandehuri nuk është ngarkuar me përgjegjësinë e komandës. Aftësia për të ushtruar kontroll mbi qendrën e paraburgimit në Likoc është elementi kryesor i kësaj mënyre të përgjegjësisë. Ndërsa trupi gjykues pranon se Aktakuza mund të ketë qenë më e saktë në përdorimin e termave të saktë që përcaktojnë secilën mënyrë të përgjegjësisë, trupi gjykues është i mendimit se Aktakuza përfshin përshkrimin e përgjegjësisë së komandës. Prandaj, trupi gjykues e hedh poshtë këtë pretendim si të pabazuar.

- *Elementet e përgjegjësisë komanduese nuk janë vërtetuar*

95. Mbrojtja e SL dhe SS theksojnë se Gjykata e Apelit nuk ka arritur të përcaktojë elementet e përgjegjësisë komanduese në lidhje me Pikën IX. Përgjegjësia e komandantit ka kushte të caktuara strikte. Elementet në vijim duhet të vërtetohen përtej dyshimit të arsyeshëm: (1) vepra penale ose mosveprimi i kryer nga dikush tjetër përveç të pandehurit; (2) marrëdhëniet epror-vartës; (3) eprori e ka ditur ose kishte një arsye për të ditur se vartësi i tij ishte gati të kryejë ose tashmë kishte kryer veprën penale; (4) i pandehuri nuk ka ndërmarrë veprimet e nevojshme për parandalimin apo ndëshkimin e vartësve të tij/saj për veprën penale.

96. Gjithashtu është e nevojshme të vërtetohet kontrolli efektiv. Nuk mjafton të provohet autoriteti *de jure*. Mbrojtja pretendon se në rastin në fjalë, gjykatat thjesht ka konstatuar se SL dhe SS [pozita e mbajtur]. Gjykata e Apelit vlerësoi më tej se dëshmia e dëshmitarit BG ishte e mjaftueshme për të treguar se të dy të pandehurit kishin fuqinë efektive për të marrë vendime në Shtabin e UÇK-së. Megjithatë, deklarata e dëshmitarit BG i cili e ka pranuar se ai kurrë nuk e kishte parë SL duke u dhënë urdhra të tjerëve, nuk është marrë parasysh. Gjatë shqyrtimit kryesor kishte shumë dëshmitarë të cilët dëshmuuan se SL nuk kishte përgjegjësinë e komandës apo kontrollin efektiv. Mbrojtja argumenton se deklarata e BG se “sa herë që kishte ndonjë çështje me UÇK-në, ai ishte i gatshëm të takohej me SS dhe SL” nuk është e

mjaftueshme për të treguar se SL ka ushtruar kontroll efektiv. Kjo fjali është nxjerrë nga konteksti dhe është në kundërshtim me pjesët e tjera të deklaratës së dëshmitarit. BG ishte vetëm dy herë në Likoc dhe kurrë nuk e ka takuar SL ose nuk ka qenë i pranishëm kur janë dhënë urdhrat ushtarake; Prandaj, sipas mbrojtjes, ai nuk mund të dinte marrëdhënien epror-vartës, ose aftësinë e eprorëve për të marrë vendime. Më tej, mbrojtja pretendon se Gjykata e Apelit nuk e ka marrë në konsideratë deklaratën e Dr. FB, i cili ka parë SL vetëm si pacient. Mbrojtja e SS shton se ai nuk mund të shpallet fajtor për përgjegjësi komanduese nëse ai ishte i përfshirë në mënyrë aktive në kryerjen e një krimi.

97. Mbrojtja e SL shton se Gjykata e Apelit nuk ia ka dalë të dëshmojë përtej dyshimit të arsyeshëm se SL e ka ditur apo ka pasur arsye ta dinte se çfarë po ndodhte në qendrën e ndalimit. Së pari, nuk ka prova që tregojnë se SL ka qenë i përfshirë në rrahjen e të ndaluarve, trajtimin e tyre mizor, të vrazhdë, poshtërues dhe degradues. Së dyti, hapësira e kufizuar e shtabit qendror nuk mund të konsiderohet si elementi i vetëm që dëshmon elementin mendor.
98. Mbrojtja pretendon se Gjykata e Apelit gabimisht ka konstatuar që SL nuk e ka ushtruar autoritetin e tij për ti ndërprerë veprimet që ishin kryer atje. SL kryesisht nuk ka qenë i pranishëm në burgun në Likoc, prandaj elementi mendor nuk mund të konsiderohet si i vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm.
99. Gjykata Themelore ka konstatuar se nuk ka pasur prova që përpos Dëshmitarit A, ka pasur njerëz të tjerë që janë maltretuar në qendrën e ndalimit, dhe se nuk mund të dëshmohet se të pandehurit kanë ushtruar kontroll efektiv mbi qendrën e ndalimit (*shih* paragrafët 210-217 të Aktgjykimit P 938/13 të Gjykatës Themelore në Prishtinë). Në anën tjetër Gjykata e Apelit nuk është pajtuar me Gjykatën Themelore në lidhje me të dy aspektet. Gjykata e Apelit është pajtuar se dëshmia e Dëshmitarit A është e besueshme. Ky dëshmitar ka dëshmuar qartë në lidhje me shumë individë në qendrën e ndalimit që ishin maltretuar. Rrahja konsiderohet si pjesë e trajtimit mizor, nënçmues dhe degradues. Më tej, Gjykata e Apelit ka treguar se në rastin aktual, duhet të konsiderohet koncepti i përgjegjësisë komanduese. Ka prova të bollshme për të dëshmuar se të gjithë të pandehurit kanë mbajtur pozita të larta brenda

strukturës së UCK-së. Gjykata e Apelit ka konstatuar se ka prova të mjaftueshme (me theks, deklarata e BG) që tregojnë se SS dhe SL kanë pasur kontrolle efektive mbi kampin. Në lidhje me njohurinë, Gjykata e Apelit ka vërtetuar se SS ka qenë një kryes aktiv i rrahjes së të ndaluarve dhe kjo dëshmon njohurinë e tij. Në lidhje me SL, pjesëmarrja e tij direkte nuk është vërtetuar. Megjithatë, për shkak të pozitës së tij të lartë dhe kontrollit efektive mbi kampin, njohuria është vërtetuar (*shih* faqet 43-46 të Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit PAKR 455/15).

100. Në fillim, Shumica e Trupit Gjykoës në tërësi pajtohet me konstatimet e Gjykatës së Apelit në lidhje me faktin se ka pasur një qendër të ndalimit në Likoc, të paktën në kohën e zënies së Dëshmitarit A. Shumica e Trupit Gjykoës rikujton se Dëshmitari A ishte deklaruar si dëshmitar i besueshëm dhe se ai në detaje të sakta e ka përshkruar ndalimin e një numri njerëzish si dhe kushtet ku ishte mbajtur ai dhe njerëzit e tjerë brenda.

101. Trupi Gjykoës tani i kthehet analizës së përgjegjësisë komanduese. Neni 161 (1) i KPK-së përcakton përgjegjësinë komanduese të komandantit ushtarak me sa vijon:

1. Komandanti ushtarak ose personi i cili në mënyrë efektive vepron si komandant ushtarak është penalisht përgjegjës për veprat penale të përcaktuara në nenet 148-156 të këtij Kodi të kryera nga forcat nën komandën dhe kontrollin e tij efektive ose nën autoritetin dhe kontrollin efektive si rezultat i dështimit të tij për të ushtruar kontrollin e duhur mbi forcat e tilla, ku:

1.1. ai komandant ushtarak apo person ose e ka ditur ose për shkak të rrethanave të asaj kohe është dashur të dijë se ato forca po kryenin ose ishin përgatitur të kryenin vepra penale të tilla; dhe

1.2. ai komandant ushtarak ose person nuk i ka ndërmarrë të gjitha masat e arsyeshme dhe të nevojshme brenda kompetencave të tij për të parandaluar ose për të ndaluar kryerjen e tyre apo për të dorëzuar çështjen te organet kompetente për hetim dhe ndjekje.

102. Ky nen është në linjë me praktikën e tribunaleve ndërkombëtare. Është vërtetuar gjerësisht se ekzistojnë tre elemente të përgjegjësisë komanduese: (i) ekzistimi i një marrëdhënieje të eprorit-vartësi mbi kontrollin efektive ndërmjet të akuzuarit dhe kryesit të krimit; dhe (ii) njohuria, apo njohuria konstruktive e të akuzuarit se krimi do të bëhet, po bëhet apo është kryer; dhe (iii) dështimi nga ana e të akuzuarit për të ndërmarrë masat e

domosdoshme dhe të arsyeshme për të parandaluar apo ndaluar në tërësi krimin apo për të dënuar kryesin<sup>12</sup>. Trupi gjykues vëren se Gjykata e Apelit saktë i ka vërtetuar elementet kryesorë të përgjegjësisë komanduese.

103. Doktrina e përgjegjësisë komanduese artikullohet qartë në raportin ndërmjet eprorit dhe vartësit dhe përgjegjësisë së komandantit për veprimet e pjesëtarëve të trupës së tij. Prandaj, është e rëndësishë thelbësore të tregohet raporti ndërmjet komandantit dhe vartësit të tij/saj. Hapi i parë në vërtetimin e një raporti të tillë është vlerësimi i pozitës zyrtare të komandantit. Një pozicion formal i autoritetit mund të përcaktohet duke iu referuar emërimit zyrtar apo dhënies formale të autoritetit<sup>13</sup>. Në rastin aktual, Gjykata e Apelit ka konstatuar saktë se SL dhe SS kanë pasur emërimet të qarta brenda strukturës së UCK-së. SS [pozita e mbajtur] kurse SL [pozita e mbajtur], më vonë i avancuar [në pozitën] (*shih* faqen 45 të Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit PAKR 455/15).

104. Trupi gjykues në vazhdim vëren se edhe pse ka pasur prova të mjaftueshme për të vërtetuar pozicionet zyrtare të të pandehurve, nuk ka prova për të treguar detyrat e [pozitat]. Nuk ka prova të asnjë udhëzimi të lëshuar ndaj vartësve, apo ndonjë provë që tregon përgjegjësinë e të pandehurit për tu marrë me çështjet disiplinore. Lidhja e vetme ndërmjet Shtabit të Zonës Operative të Drenicës dhe qendrës së ndalimit duket se ato kanë qenë në të njëjtin objekt (*shih* faqe 45 të Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit PAKR 455/15). Nuk ka prova lidhur me themelimin e qendrës së ndalimit, komandës dhe strukturave të kontrollit që mund të kenë ekzistuar në atë qendër ndalimi, apo ndonjë emërim zyrtar.

105. Prandaj, Trupi gjykues konsideron se është e rëndësishë primare në rastin aktual që të vlerësohet nëse të pandehurit SL dhe SS kanë ushtruar kontroll efektiv mbi vartësit e tyre. Forca e autoritetit për të parandaluar ose ndëshkuar nuk lind vetëm nga autoriteti *de jure* që merret përsipër përmes emërimit zyrtar. Në shumë konflikte bashkëkohore, mund të ketë vetëm qeveri *de-facto* të vetëshpallura dhe kështu *de facto* ushtri dhe grupe paramilitare që

---

<sup>12</sup> ICTR, Bagilishema, (Trupi Gjykues), 7 qershor 2011, paragrafi 38

<sup>13</sup> Tribunali i Hagës, Kordic dhe Cerkez, TC, Aktgjykimi, Rasti Nr. IT-95-14/2-T, 26 shkurt 2001, par 419.

varen nga jo. Struktura komanduese, e organizuar në mënyrë të ngutshme mund të jetë e çrregullt dhe e thjeshtë. Zbatimi i ligjit në këto rrethana kërkon një vendosmëri të përgjegjësive jo vetëm të kryesve individual por edhe të komandantëve të tyre apo eprorëve të tjerë të cilët e kishin kontrollin mbi ta, edhe pse pa ndonjë emërim formal<sup>14</sup>.

106. Parimi i përgjegjësive komanduese duhet të zbatohet vetëm mbi ata eprorë të cilët ushtrojnë kontroll efektiv mbi vartësit e tyre. Koncepti i kontrollit efektiv mbi një vartës – në kuptim të mundësisë materiale të parandalimit apo ndëshkimit të sjelljes kriminale, si do që ai kontroll të ushtrohet – është pragu që duhet arritur në vërtetimin e raportit epror – vartës për qëllim të nenit 161 (1) të KPK. Kontrolli efektiv do të thotë mundësia materiale për të parandaluar kryerjen e veprës ose për të dënuar kryesit kryesorë. Ky kriter nuk përmbushet vetëm përmes tregimit të ndikimit të përgjithshëm të një të akuzuari. Thënë kështu, treguesi për ekzistimin e kontrollit efektiv është më shumë ‘çështje e provave (e të provuarit) se sa e të drejtës materiale’, në varësi të rrethanave të secilit rast, dhe se ata tregues kufizohen në tregimin e asaj se i dyshuari ka pasur fuqinë për të parandaluar, shtypur dhe/ose paraqitur rastin para autoriteteve kompetente për hetim. Për shembull, në Aktgjykimin *Kordic* dhe *Cerkez*, Tribunali i Hagës ka theksuar që “kapaciteti për të nënshkruar një urdhër do të jetë tregues i pak autoriteti. Autoriteti për të lëshuar urdhra, sidoqoftë, mund të supozohet de facto. Prandaj me qëllim të përcaktimit të drejtë të fuqisë reale dhe aktuale të kontrollit të një eprori, do të jetë e domosdoshme të shikohet substanca e dokumenteve të nënshkruara dhe nëse ka prova se ato janë zbatuar<sup>15</sup>. Më tej, në një rast tjetër, Tribunali ka vërejtur se disa prova se një i akuzuar jo vetëm që është në pozitë për të lëshuar urdhra por që urdhrat e tij në fakt janë zbatuar ofron një shembull të kontrollit efektiv<sup>16</sup>.

---

<sup>14</sup> Tribunali i Hagës, Mucic et al (“Celebici”), AC, Aktgjykimi në Ankesë, Rasti Nr. IT-96-21-A, 20 shkurt 2001, par 193.

<sup>15</sup> Tribunali i Hagës, Kordic dhe Cerkez, TC, Aktgjykimi, Rasti Nr IT-95-14/2-T, 26 shkurt 2001, para 421, që konfirmon Tribunali Mucic et al (“Celebici”), TC, Aktgjykimi, Rasti Nr IT-96-21-T, 16 nëntor 1998, par 672. Po ashtu, Naletelic dhe Martinovic, TC, Aktgjykimi, Rasti Nr. IT-98-34-T, 31 mars 2003, par 67.

<sup>16</sup> ICTR, NYIRAMASUHUKO, et al (Butare), (ICTR-98-42-A), Aktgjykimi në Ankesë – 14.12.2015, paragrafi 2568.

107. Në rastin aktual, Gjykata e Apelit ka konstatuar se të pandehurit kanë qenë në [pozitë] që ka qenë në të njëjtin objekt me qendrën e ndalimit. Më tej, Gjykata e Apelit është mbështetur në dëshminë e dëshmitarit Bajram Gashi i cili ka thënë se kur do që ka pasur ndonjë problem me UCK-në, ai ishte i gatshëm të takohej me SS dhe SL (*shih* faqe 45 të Aktgjyimit të Gjykatës së Apelit PAKR 455/15). Trupi gjykues vëren se kjo provë është e pamjaftueshme për të dëshmuar që SL dhe SS kanë qenë në mënyrë efektive duke ushtruar komandë ushtarake mbi qendrën e ndalimit në Likoc. Provat e paraqitura në rast dëshmon përtej dyshimit të arsyeshëm pozitën e tyre në zinxhirin komandues të UCK-së se sa aftësinë e tyre për të ushtruar kontroll efektiv mbi qendrën e ndalimit. Prandaj, Trupi gjykues gjen se asnjë tregues faktit nuk ka mundur të gjejë se emërimi si [pozita] apo thjeshtë prania në qendrën e ndalimit tregon kontrollin efektiv mbi vartësit e eprorëve, që, nga ana tjetër, ka detyruar autoritetin të parandalojë ushtarët nga kryerja e krimeve ose ndëshkimi i tyre për krimet e kryera. Rrjedhimisht, Trupi gjykues konstaton se nuk është vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm se SS dhe SL kanë ushtruar kontroll efektiv mbi qendrën e ndalimit.
108. Trupi gjykues po ashtu vëren se shkalla e kontrollit efektiv të eprorit drejton (udhëheq) vlerësimin e nëse një individ ka ndërmarrë masa të arsyeshme për të parandaluar, ndaluar ose dënuar një krim të vartësit. Në këtë drejtim, Gjykata e Apelit nuk e ka adresuar çështjen nëse të pandehurit SL dhe SS kanë ndërmarrë ndonjë masa për ti ndaluar veprimet e paligjshme. Kështu, Trupi gjykues vëren se kjo çështje nuk ishte diskutuar as në gjykimin kryesor. Prandaj, Trupi gjykues nuk mund të bëjë një analizë bindëse të këtij elementi të përgjegjësisë komanduese. Në bazë të nenit 3(2) të KPP, dyshimet në lidhje ekzistimin e fakteve që janë me rëndësi për rastin do të interpretohen në favor të të pandehurit. Rrjedhimisht, Trupi gjykues është i mendimit se të pandehurit SL dhe SS nuk mund të konsiderohen përgjegjës për përgjegjësinë komanduese.
109. Si element i fundit i përgjegjësisë komanduese, është e domosdoshme të vërtetohet se komandanti/eprori e ka ditur, ose ka pasur arsye ta di se vartësi i tij ka kryer ose ka për të kryer një veprë penale. Njohuria e eprorit nuk mund të pre supozohet, por mund të vërtetohet përmes provave rrethore. Faktorët për tu marrë parasysh me rastin e vërtetimit të njohurisë përfshin: numrin, llojin dhe gamën e veprimeve të paligjshme, kohën gjatë të cilës kanë

ndodhur, numrin e vartësve të përfshira, lokacionin gjeografik; nëse aktet kanë me shtrirje të gjerë, lokacioni i të akuzuarit në atë kohë dhe faktorë të tjerë. Duhet cekur se sa më larg fizikisht eprori të ketë qenë nga vendi, më shumë prova duhen për të dëshmuar njohurinë e tij. Anasjelltas, kryerja e një krimi shumë pranë vendit ku eprorit i ka kryer zakonisht detyrat e tij do të mjaftonte për të vërtetuar një tregues të rëndësishëm se ai ka pasur njohuri për krimin, *a fortiori* nëse krimet janë kryer në vazhdimësi. Kolegji thekson se në çështjen në fjalë, i pandehuri SS ishte kryerësi i drejtpërdrejtë ndërsa SL në atë kohë ishte i pranishëm në Shtabin Qendror (shih faqen 45 të Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit PAKR 455/15). Edhe pse mund të jetë dëshmi e mjaftueshme rrethanore në rastin në fjalë për të vërtetuar njohuritë e të pandehurve, kolegji konsideron se përgjegjësia e komandës është një mënyrë e përgjegjësisë që bazohet në mosveprim. Duke arritur në përfundimin se marrëdhënia efektive epror-vartës dhe dështimi për të vepruar nuk janë vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm, njohuria e mundshme e veprës penale në rastin aktual nuk mjafton për t'i konsideruar të pandehurit penalisht përgjegjës si komandantë.

**110. Duke arritur në përfundim se elementet e përgjegjësisë komanduese nuk janë vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm, kolegji shfajëson të pandehurit SS dhe SL nga vepra penale siç është detajuar në Akuzën IX.**

- *Vendimi mbi dënimin*

111. Sipas nenit 64 (1) të KPPK-së, gjykata do ta përcaktojë dënimin brenda kufijve të parashikuar me ligji për një vepër të tillë penale, duke marrë parasysh qëllimin e dënimit, rrethanave lehtësuese dhe rënduese dhe në veçanti shkallën e përgjegjësisë penale, motivet, intensitetin e rrezikut për vlerën juridike të mbrojtur, rrethanat në të cilat është kryer vepra, sjelljen e kaluar të autorit të krimit, pranimin e fajësisë ose marrëveshjen e fajësisë, rrethanat personale të autorit të krimit dhe sjelljen e saj/tij pas kryerjes së veprës penale. Përveç kësaj, dënimi duhet të jetë proporcional.

112. Gjykata Themelore i konsideroi rrethanat rënduese dhe lehtësuese në lidhje me SS dhe SL. Veçanërisht, Gjykata Themelore konkludon se SL veproi në mënyrë flagrante me



mospërfillje të hapur për mundësinë e zbulimit të krimit të tij nga dëshmitari. Në lidhje me SS, Gjykata Themelore mori parasysh shkallën e vuajtjes së shkaktuar ndaj dëshmitarit A si rrethana lehtësuese, në lidhje me të dy të pandehurit, Gjykata Themelore mori parasysh faktin se ata të dy kishin pozita të rëndësishme dhe prestigjioze që shërbenin publikun dhe atë se ata po luftonin për kombin e tyre (shih paragrafët 298-302 të Aktgjykimit të Gjykatës Themelore P 938/13). Gjykata e Apelit shqyrtoi faktet se të pandehurit SS, SL dhe JD po jetojnë një jetë të ndershme pas luftës si rrethanë lehtësuese. Megjithatë, Gjykata e Apelit e refuzoi luftën si pjesëtarë të UÇK-së si rrethanë lehtësuese. Në lidhje me rrethanat rënduese, Gjykata e Apelit mori parasysh faktin se SS ishte [në pozitë] dhe në shumicën e rasteve kishte më shumë autoritet se SL (shih faqen 55 të Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit PAKR 455/15).

113. Lidhur me të pandehurin JD, shumica e kolegjit konsideron se Gjykata e Apelit i ka vlerësuar saktë rrethanat lehtësuese. Shumica e kolegjit thekson më tej se Gjykata e Apelit nuk identifikoi ndonjë rrethanë rënduese lidhur me JD. Prandaj, shumica e kolegjit konsideron se Gjykata e Apelit i ka marrë në konsideratë rrethanat e përgjithshme dhe plotësisht pajtohet me gjetjet e Gjykatës së Apelit lidhur me përcaktimin e dënimit për të pandehurin JD.
114. Kolegji merr në konsideratë se në aktgjykimin aktual të pandehurit SL dhe SS u shpallën të pafajshëm për veprën penale siç përshkruhet në Akuzën IX. Prandaj, shumica e kolegjit konsideron se dënimi i shqiptuar për të pandehurit SL dhe SS do të modifikohet.
115. Në lidhje me të pandehurin SL, kolegji merr parasysh se i pandehuri është shfajësuar nga dy vepra penale nga Gjykata Themelore dhe më vonë nga Gjykata e Apelit dhe thekson se ai është shfajësuar nga vepra penale siç përshkruhet në Akuzën IX me këtë aktgjykim. Si i tillë, i pandehuri u shfajësua nga të gjitha akuzat. Prandaj, në pajtim me nenin 403 (3) të KPP-së, kolegji e pushon paraburgimin kundër SL dhe urdhëron lirin e menjëhershëm të tij.
116. Në lidhje me të pandehurin SS, shumica e kolegjit së pari konsideron se dënimi do të modifikohet për shkak se i pandehuri është shfajësuar nga vepra penale siç përshkruhet në

Akuzën IX me këtë aktgjykim. Gjatë rishqyrtimit të dënimit, shumica e kolegjit pajtohet plotësisht me rrethanat lehtësuese dhe rënduese të analizuara nga Gjykata e Apelit. Gjegjësisht, si rrethanë lehtësuese, shumica e kolegjit konsideron se i pandehuri SS jeton një jetë të ndershme pas luftës dhe ka mbajtur një pozitë të rëndësishme për t'i shërbyer interesit publik. Si rrethanë rënduese, shumica e kolegjit konsiderojnë faktin se SS ishte [në pozitë] dhe si i tillë kishte një rol të rëndësishëm brenda UÇK-së. Shumica e kolegjit më tej vëren se i pandehuri SS është dënuar me 5 (pesë) vjet dhe 3 (tre) muaj burg nga Gjykata e Apelit për veprën penale siç përshkruhet në Akuzën IV. Së fundi, pjesa më e madhe e kolegjit konsideron se Gjykata e Apelit ka zbatuar në mënyrë të drejtë nenin 82 të KPK-së dhe ka marrë parasysh dënimin e caktuar ndaj SS nga Gjykata e Apelit në rastin PAKR 456/2016 (domethënë 7 (shtatë) vjet burgim ). Prandaj, në bazë të neneve 80 (1) dhe (2) (2.2) dhe 82 (1) të KPK-së, duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e lartpërmendura dhe parimin *reformation in peius*, shumica e kolegjit ia cakton të pandehurit SS dënimin me 8 (tetë) vjet burgim.

**Është vendosur si në dispozitiv lidhur me të lartpërmendurat.**

**Kryetari i trupit gjykues**

**Procesmbajtëse**

\_\_\_\_\_  
**Krassimir Mazgalov**  
**Gjyqtar i EULEX-it**

\_\_\_\_\_  
**Sandra Gudaityte**  
**Zyrtare ligjore e EULEX-it**

**Anëtarët e kolegjit**

\_\_\_\_\_  
**Arnout Louter**  
**Gjyqtar i EULEX-it**

\_\_\_\_\_  
**Emine Mustafa**  
**Gjyqtare e Gjykatës Supreme**

